



## FORCA AJRORE



Ministria e Mbrojtjes, Kodheli, inspekton Bazën Ushtarake Ajrore në Kuçovë

Kodheli dhe gjeneralmajor Bazo inspektuan nga afër mjediset e Bazës dhe u takuan me ushtarakët e punonjësit

faqe 4

## FORCA TOKËSORE

Kryetari i Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Bartels, viziton BFS

faqe 6

## SIGURIA

NATO dhe Rusia  
Koha për t'u angazhuar

Fjala e sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s në Konferencën e 50 të Sigurisë së Mynihut

faqe 10

## BRIGADA LOGJISTIKE



Grup-depot e Murrashit marrin certifikatën e pastërtisë

Zëvendësministri i Mbrojtjes Dritan Hila vlerëson punën e specialistëve QAME

faqe 3

## TAKIMI

Gjeneralmajor Bazo: Prioriteti ynë kryesor, paketa e Objektivave të Kapaciteteve 2013-2019

SHSHP të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo takon kryetarin e Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels



faqen 3

Kryetari i Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels, vizitë në Tiranë

# Gjenerali Bartels vlerëson reformat e Mbrojtjes dhe rolin e Shqipërisë në rajon


Ministria Kodheli: Ne jemi krenar jo vetëm për numrin e konsiderueshëm të forcave të dërguara në misione paqeruajtëse, por edhe për cilësinë e tyre. Në këtë këndvështrim, dëshiroj të theksoj se do të jemi pjesë e pandarë e NATO kudo që të lindë nevoja.



faqen 2-3

## DUKE KUJTUAR GJURMËN E LAVDISHME TË UÇK-SË, KUJTOJMË PJESËN MË TË NDERUAR TË KOMBIT

# Kosova dhe Ushtria e saj Çlirimtare



Në datën 31 janar u mbushën 17 vjet nga rënia heroike e dëshmorëve të kombit, që dhanë jetën për pavarësinë e Kosovës, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, të cilët u vranë në Pestovë të Vushtrrisë, në një pritë të organizuar nga regjimi serb. Ata ishin pushka e parë e Lirisë, dëshmorët e parë të çështjes së lartë të çlirimit të Kosovës, ishin simboli i gjakut të dhënë për kombin. Heronj si Zahir Pajaziti, një prej pionierëve të themelimit të UÇK-së, do të mbesin përjetë në kujtesën historike shqiptare, si për vlerat e tyre edhe për guximin e treguar. Mëngjesin e datës 31 janar, kryeministri Thaçi, kryetari i Komunitetit të Prishtinës, Shpend Ahmeti, lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurtin dhe persona të...  
faqe 8-9

## ANALIZA

Ditar nga BII i Këmbëtorisë së Motorizuar, prioritet i FT

faqe 6

## NËNOFICERI

Hapen kurset e para për vitin 2014 në ANO

faqe 11

## SAS

Historia e grupit më të mirë botë për operacionet speciale

faqe 14

## PËRFAQËSUESIT E OBM-së



Vlerësohet puna e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak

Përfaqësues të lartë të Organizatës Botërore të Meteorologjisë, vizitë pune në ambientet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, Tiranë

faqe 4



Shqipëria e gatshme për të qenë pjesë e misionit "Resolute Support" në Afganistan

# Gjenerali Bartels vlerëson reformat në fushën e Mbrojtjes dhe rolin e Shqipërisë në rajon

**M**inistrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli ka pritur pasditen e datës 5 shkurt 2014, kryetarin e Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels, i cili në krye të një delegacioni të lartë ushtarak po viziton vendin tonë. Ministrja Kodheli, pasi i uroi gjeneral Bartels mirëseardhjen në Tiranë, është shprehur se vizita juaj në vendin tonë është një tregues i qartë i marrëdhënieve të shkëlqyera mes Shqipërisë dhe NATO dhe vullnetit të ndërsjellë për t'i forcuar ato edhe më tej në të ardhmen. Në vijim të takimit, ministrja Kodheli i rikonfirmoi gjeneral Bartels qëndrimin e palëkundur të qeverisë shqiptare dhe të Ministrisë së Mbrojtjes për të vazhduar të jemi anëtarë dinjitozë të Aleancës duke përbushur detyrimet, duke marrë pjesë dhe kontribuar në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, si dhe e njohu me prioritetet e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2014, me ecurinë e procesit të reformimit në fushën e Mbrojtjes, me çështje të bashkëpunimit rajonal etj. Pas këtij takimi, ministrja e Mbrojtjes Kodheli dhe gjeneral Bartels dhanë nga një deklaratë për shtyp.



## Ministrja Kodheli: Do të jemi pjesë e pandarë e NATO-s kudo që të lindë nevoja

Sot pata kënaqësinë të pres në zyrën time gjeneral Bartels, Kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO. Vizita e gjeneral Bartels flet për marrëdhënie të shkëlqyera mes Shqipërisë dhe NATO dhe vullnetin e ndërsjellë për t'i forcuar ato edhe më tej në të ardhmen. Gjatë takimit me Gjeneral Bartels, pasi rikonfirmova qëndrimin tonë të palëkundur për të vazhduar të jemi anëtarë dinjitozë të Aleancës duke përbushur detyrimet, duke marrë pjesë dhe kontribuar në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, e njohja kryetarin e Komitetit Ushtarak me prioritetet e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2014, me ecurinë e procesit të reformimit në fushën e Mbrojtjes, me çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin rajonal etj. Përveç arritjeve të deritanishme në procesin e reformimit në fushën e Mbrojtjes, me fokus luftën kundër korrupsionit, implementimin e Dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, u ndala edhe në planet e detajuara për arritjen e Objektivave të Kapaciteteve të caktuara për vendin tonë, si dhe përfundimin e dokumenteve strategjike, ku do përmendja Strategjinë Ushtarake dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura. Në lidhje me kontributin në operacionet paqeruajtëse të NATO, ne jemi krenarë jo vetëm për numrin e konsiderueshëm të forcave të dërguara në mision, por edhe për cilësinë e tyre, duke kaluar nga forca mbështetëse në forca të angazhimit në luftim dhe forca trajnuese. Në këtë këndvështrim, dëshiroj të theksoj se do të jemi pjesë e pandarë e NATO kudo që të lindë nevoja. Po kështu, në përputhje me objektivat e procesit të tranzicionit në përfundim të misionit ISAF, dëshiroj të shpreh edhe njëherë gatishmërinë dhe vullnetin e institucionit që unë kryesoj për të qenë pjesë e misionit "Resolute Support" në Afganistan. Bashkëpunimi rajonal është një tjetër çështje e rëndësishme për të cilën jemi të vendosur ta



trajtojmë me përparësi edhe në të ardhmen. Si një vend anëtar i NATO ne jemi të gatshëm të japim një rol akoma më të madh në rajon pasi jemi të bindur se vetëm përmes bashkëpunimit mundësohet stabiliteti politik, siguria dhe prosperiteti ekonomik. Në këtë këndvështrim, vlerësojmë si mjaft të rëndësishme iniciativat e A5 dhe SEDM dhe si vend mbështetës i politikës së dyerve të hapura të NATO, inkurajojmë fort përpjekjet e vendeve të rajonit, pa përjashtim, në përbushjen e kriterëve për anëtarësim. Dëshiroj të theksoj se, për ne, bashkëpunimi me vendet e rajonit, merr një rëndësi të veçantë. Në këtë kontekst, dëshiroj të shpreh angazhimin e Shqipërisë si kryesuese e radhës së Iniciativës së A5 për t'i dhënë një dimension të ri këtij bashkëpunimi dhe për ta bërë atë më shumë të orientuar drejt NATO. Shqipëria vlerëson dhe mbështet progresin e admirueshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Marrëveshja e prillit 2013 mes Kosovës dhe Serbisë është tregues i një qasje të re dhe konstruktive, si dhe vullnetit politik për një të ardhme më të mirë të së dy vendeve. Diskutimet tona u ndalën edhe në përgatitjen për një ngjarje të rëndësishme të NATO, siç është Samiti i NATO, që do të zhvillohet në shtator në Britaninë e Madhe. Ky Samit, i cili përkon me një tjetër ngjarje të rëndësishme, atë të tërheqjes nga Afganistani, do të trajtojë një sërë çështjesh të rëndësishme, mes të cilave atë të "Post ISAF 2014". Mbatjtja e gatishmërisë së Forcave të Deklaruara në NATO, mbajtja e nivelit të kapaciteteve të mbrojtjes dhe shpenzimeve të mbrojtjes janë domethënëse për unitetin e Aleancës, i cili shprehet të rikonfirmohet në këtë Samit. Së fundi, dëshiroj t'ju bëj me dije se nën kujdesin e veçantë të kryeministrit Rama, Shqipëria do të jetë vendi, i cili do të mirëpresë në muajin maj takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut, një ngjarje e rëndësishme për përgatitjen e së cilës ne jemi të angazhuar maksimalisht.

## Gjeneral Bartels: Mbështes angazhimin e vazhdueshëm rajonal të Shqipërisë

Së pari dua të shpreh kënaqësinë time të veçantë që jam kryetari i parë i Komitetit të NATO, që vizitohet Shqipërinë, nga momenti që Shqipëria është bërë vend anëtar i NATO, në vitin 2009. Shqipëria konsiderohet si një aleat i çmueshëm i Aleancës për shkak të angazhimit të saj në mbrojtjen tonë kolektive dhe operacionet. Shqipëria po jep një kontribut të rëndësishëm në misionet tona në Afganistan dhe në Kosovë. Përveç kësaj, ne vlerësojmë kontributin dhe përpjekjet e Shqipërisë për të bashkuar burimet trajnuese me Kroacinë dhe vendet e tjera të rajonit në kuadër të Kartës së Adriatikut A5, të cilën Shqipëria aktualisht e kryeson. Në këndvështrimin e NATO përfshirja rajonale e Shqipërisë në bashkëpunimin e mbrojtjes dhe të sigurisë është e vlerësueshme dhe e çmuar, për shkak se përfshin kapacitete themelore të mbrojtjes dhe për më tepër edhe çështje të sigurisë në kuadër të iniciativës A5. Bashkëpunimi i ngushtë mes vendeve aleate dhe partnere për kapacitetet dhe ndërveprueshmërinë është themelore për të përgatitur NATO-n për sfidat në të ardhmen. Duhet të jemi të aftë bashkëpunojmë së bashku dhe të gjejmë rrugët më të mira për të përdorur në mënyrë më efektive paratë e taksapaguesve. Gjatë takimit tonë unë e informova gjithashtu ministrin e Mbrojtjes për prioritetet që lidhen me reformat e Mbrojtjes, iniciativat për të luftuar korrupsionin dhe për të rishikuar strukturat dhe proceset. Përshtatja e vazhdueshme në organizatë është e rëndësishme për Forcat e Armatosura për të përbushur sfidat e së ardhmes. Prandaj dua të shpreh mbështetjen për reformat në fushën e mbrojtjes, si dhe angazhimin e vazhdueshëm rajonal të Shqipërisë.







# Gjeneralmajor Bazo: Prioriteti ynë kryesor, paketa e Objektivave të Kapaciteteve 2013-2019

*SHSHP të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo takon kryetarin e Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels*

Në sheshin kryesor të Garnizonit "Skënderbej", u zhvillua në datën 5 shkurt 2014, një ceremoni e veçantë me rastin e vizitës së kryetarit të Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels. Gjeneral Bartels u prit me truproje nderi nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Të pranishëm në ceremoni ishin zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Viktor Berdo, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP. Kryetari i Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels, u prit në një takim të veçantë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjatë takimit u vlerësua progresi që kanë bërë Forcat e Armatosura shqiptare që prej anëtarësimit në NATO, gjë e cila u finalizua me deklaratën për integrimin e plotë të Shqipërisë në NATO në muajin tetor. Gjeneral Bazo informoi gjeneral Bartels për angazhimin e Shqipërisë për rishikimin e dokumenteve strategjike, gjë që do të reflektojë angazhimet e Shqipërisë jo vetëm ndaj NATO, por edhe krijimit të ambientit të sigurisë dhe promovimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. "Shqipëria përfundoi Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes në muajin prill 2013 dhe aktualisht janë duke u implementuar konkluzi-

onet e këtij dokumenti, sidomos në transformimin e FA dhe prioritetet e saj për vitin 2014", është shprehur gjeneral Bazo. Më tej, gjeneral Bazo është ndalur në kontributin që Forcat e Armatosura shqiptare vazhdojnë të japin në operacionet e NATO (ISAF, KFOR) dhe ato të BE (ALTHEA), duke theksuar që Shqipëria ka shprehur angazhimin e saj për të marrë pjesë edhe në operacionet (post ISAF), pas 2014. "Shqipëria është angazhuar për përmbytjen e detyrimeve të NATO nëpërmjet procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO dhe ka si prioritet kryesor implementimin e paketës së Objektivave të Kapaciteteve 2013-2019. Ajo mbetet e angazhuar në bashkëpunimin me shtetet e rajonit nëpërmjet formateve të ndryshme të bashkëpunimit, si Karta e Adriatikut (A-5), iniciativa e shefave të Shtabëve të Mbrojtjes të Ballkanit, Ministeriali i Mbrojtjes së Vendeve të Evropës jug-lindore (SEDM), si dhe do të vazhdojë për të promovuar

stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik në rajon", ka theksuar gjeneral Bazo. Duke u ndalur në numrin e madh të rezervave të municioneve dhe armatimeve që Shqipëria trashëgoi nga e kaluara, ashtu si dhe disa vende të tjera të rajonit, gjeneral Bazo theksoi se asgjësimi i tyre mbetet një nga sukseset dhe prioritetet për sigurinë kombëtare dhe atë rajonale. Nga ana e tij, gjeneral Bartels e falënderoi gjeneral Bazon për pritjen e veçantë dhe vlerësoi me nota pozitive progresin e bërë nga Forcat e Armatosura shqiptare, si dhe kontributin që ato vazhdojnë të japin në operacionet e udhëhequra nga NATO dhe BE, duke kërkuar mbështetje për përmbytjen e detyrimeve të Shqipërisë në NATO. Më herët, kryetari i Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels u prit në një takim të veçantë nga kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe nga ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli.

*"Shqipëria është angazhuar për përmbytjen e detyrimeve të NATO nëpërmjet procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO dhe ka si prioritet kryesor implementimin e paketës së Objektivave të Kapaciteteve 2013-2019".*

## Murrashi i Librazhdit merr certifikatën e pastërtisë

*Zëvendësministri i Mbrojtjes Dritan Hila vlerëson punën e specialistëve QAME*

Zëvendësministri i Mbrojtjes Dritan Hila merr pjesë në certifikimin e Grup-Depove të Murrashit në Librazhd dhe vlerëson punën e tërë specialistëve të QAME dhe Brigadës Logjistike në një prej operacioneve më të vështira të procesit të demontimit dhe të asgjësimit të municioneve të tepërta. Në këtë operacion mori pjesë dhe koloneli në rezervë Georgy Ganata analist i lartë për Burimet, që prej disa vjetësh në Shqipëri drejton CUBIC. Certifikimi i Grup-Depove të Murrashit në Librazhd është finalizimi i një pune me përgjegjësi shumë të madhe i tërë hallkave që kanë marrë pjesë që nga Ministria e Mbrojtjes deri tek ushtari profesionist që ka kryer shërbimin e ruajtjes në to. Zëvendësministri i Mbrojtjes Dritan Hila falënderoi tërë efektivin e QAME dhe



të Rajonit të Elbasanit, dy prej njësive të rëndësishme të Brigadës Logjistike për punën e kualifikuar dhe me shumë përgjegjësi që kanë bërë. Ai konfirmoi se puna do të vazhdojë dhe procesi i demontimit dhe certifikimit të grupdepove të poligoneve është një detyrë e rëndësishme e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e tërë efektivit të Brigadës Logjistike. Zoti Dritan Hila inspektoi nga afër Grup-Depot dhe mori pjesë në ceremoninë e firmosjes së certifikimit nga zoti Arben Brahja, që drejton qendrën e certifikimeve nga drejtuesit e pushtetit vendor dhe nga tërë njësitë e Brigadës Logjistike që kishin marrë pjesë në këtë proces. Zëvendësministri Dritan Hila vlerësoi shumë punën e kapiten Artan Azizi që drejton QAME, komandantin e operacioneve Marion Alhysa, operatorin Sadri Neza dhe Selim Çerpia, dhe ndihmësmjekun Muharrem Saliko, të cilët në kohë rekord dhe me profesionalizëm bënë kontrollin e imtësishëm të një sipërfaqjeje prej 33 mijë metrash katrorë duke vendosur firmën e pastërtisë. Të gjithë drejtuesit më të lartë vlerësuan punën e efektivit dhe të Komandës së Rajonit të Elbasanit. Në emër të Brigadës Logjistike zëvendëskomandanti kolonel Besnik Sylaj informoi zëvendësministrin e Mbrojtjes Dritan Hila për punën e bërë për përkushtimin e efektivit dhe për objektivin e realizuar. Ai më tej shtoi se ky proces do të vazhdojë. Ky certifikim është eveniment i rëndësishëm i arritjes së këtij objektivi, kanë punuar për disa muaj rresht jo vetëm komanda dhe tërë trupa përbërëse e Rajonit të Elbasanit e drejtuar nga nënkolonel Edianid Elezi, por dhe Batalioni i Municioneve, i drejtuar nga nënkolonel Idris Kuca, dhe Batalioni i Furnizimit i drejtuar nga nënkolonel Dod Vukaj, të cilët në bashkëpunim me njeri tjetrin sipas një plani të hartuar me detaje nga Komanda e Brigadës Logjistike, bënë të mundur pastrimin e këtyre depove dhe tuneleve". Grup-Depo e Murrashit në Elbasan në vitin 2011 janë boshatisur dhe pastaj kanë shërbyer si magazine për municione të zbuluara në Gërdec dhe materiale të tjera xheniere. Po ashtu dhe bashkëpunimi me Prefekturën dhe drejtuesit e pushtetit vendor ka qenë shumë frytëdhënës. Për pastrimin e këtyre depove dhe kontrollin e imtësishëm të çdo centimetri të tyre për të mos mbetur asnjë grimcë municioni dhe baruti, por dhe mbetje të tjera metalike të predhava kanë punuar me shumë përgjegjësi të gjithë ushtarakët e efektivit të Rajonit të Elbasanit tha kolonel Besnik Sylaj në fjalën e tij. Ndërsa fjalët më të mira u thanë për QAME e drejtuar nga kapiten Artan Azizi dhe tërë grupet e asgjësimit, por dhe grupet e certifikimit kanë bërë të mundur që të asgjësohen me saktësi në poligonin e Voskopojës të gjitha municionet që ishin të tepërta dhe ishin magazinuar në këto Grup-Depo, por dhe për punën e tyre e cila është shumë e rrezikshme dhe kërkon përkushtim të madh dhe maksimal. Kjo punë delikate dhe me rrezikshmëri u bë dhe për pastrimin dhe certifikimin e tuneleve në Murrash. Specialistët dhe operatorët e QAME çdo ditë më tepër konfirmojnë se dinë të bëjnë operacione shumë të vështira, të komplikuar dhe pa asnjë ngjarje të jashtëzakonshme. Asgjësimi i municioneve është një sfidë e madhe që ne e kemi fituar dhe fitojmë përvojë nga dita në ditë. Në biografinë e këtij reparti janë shumë operacione të kryera me shumë përgjegjësi kolonel Besnik Sylaj tha se gjatë vitit që kaloi u certifikuan Grup-Depot në Bigas të Skraparit, Mezhgorani, Radshi dhe janë gati për certifikim Grup-Depot në Ullisht të Elbasanit, Qafë-Shtama dhe Mollëza në Burrel. Po ashtu po vazhdon puna dhe brenda muajit shkurt do të certifikohen Grup-Depot e Shmilit në Tiranë, Mbrazhdani në Berat dhe Grup-Depot në Guak të Skraparit. E historit të plotë të këtij grupi të Mbrojtjes së Depove, të cilat kanë shërbyer për mbajtjen e municioneve të Artilerisë për gati 50 vjet dhe në këto vitet e fundit janë pastruar dhe kanë marrë certifikatën e pastërtisë. Vërtet ky është një eveniment dhe një finalizim i një pune shumë të lodhshme dhe me përgjegjësi nga tërë shtabi i Brigadës Logjistike, por dhe nga Komanda e Rajonit të Elbasanit, nga Batalioni i Municioneve dhe ai i Furnizimit, por dhe nga QAME, e cila mban përgjegjësinë direkt për këtë certifikim.



# U kërkua të merren të gjitha masat e nevojshme për të sjellë projekte për këtë zonë

## Ministrja e Mbrojtjes Kodheli inspekton Bazën Ushtarake Ajrore në Kuçovë

*Kodheli dhe gjeneralmajor Bazo inspektoi nga afër mjediset e Bazës dhe u takua me ushtarakët e punonjësit*

**M**inistrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ka zhvilluar ditën e premte, në datën 31 janar 2014, një inspektim në Bazën Ushtarake Ajrore në Kuçovë. Gjatë këtij inspektimi ministrja Kodheli shoqërohej nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Frederik Beltoja. Fillimisht, ministrja Kodheli është prituri nga komandanti i Bazës Ajrore në Kuçovë, nënkolonel Tomor Dyrmo, i cili informoi mbi gjendjen aktuale të kësaj baze, si dhe me problematikat që ka aktualisht në këtë njësi ushtarake. Ministrja Kodheli dhe gjeneralmajor Bazo inspektoi nga afër mjediset e Bazës Ushtarake Ajrore të Kuçovës, si dhe u takua me ushtarakët dhe punonjësit të kësaj baze. Në fund të këtyre takimeve ministria Kodheli shprehu vullnetin dhe vendosmërinë e plotë për t'i rikthyer ndriçimin e dikurshëm kësaj baze. Ajo kërkoi të merren të gjitha masat e nevojshme për të sjellë projekte konkrete për këtë zonë, të cilat të kontribuojnë jo vetëm në favor të FA, por edhe për të gjithë komunitetin.

### Bazat Ajrore të FARSH

Bazat Ajrore të FARSH gjatë kohës që arma e Forcave Ajrore ishte me efikasitet dhe pajisje më të shumta, ishin të aktive, ndërsa sot një pjesë e tyre ato janë thjesht në ruajtje. Bazat



Ajrore të FARSH-së janë: Baza Ajrore Rinas (A), Baza Ajrore Kuçovë (A), Baza Ajrore Gjirokastër (R), Baza Ajrore Korçë Veriperëndim (R), Baza Ajrore Vlore (R). Baza Ajrore e Gjadrit është e veçantë nga bazat e tjera fale infrastrukturës që ka. Pista ajrore u ndërtua në një mënyrë që pas uljes në pistë, avioni mund futej në një tunel të nëndheshëm. E ndërtuar në vitet 70'të, kjo bazë ishte "shtëpia" e avionëve

MiG-21 dhe MiG-19. Avioni i parë që përdori pistën e kësaj baze për herë të parë e bëri këtë gjë me 10 korrik 1973. Fillimisht, Regj. 5646 u krijua me një skuadrilje avionësh MiG-19. Më vonë, 6 MiG-17UTI (FT-5) mbërritën dhe gjithashtu, skuadrilje e MiG-21 u transferua nga Rinas në Gjadër. Më 16 tetor 1976, një skuadrilje e dytë mbërriti nga Kuçova në Gjadër e pajisur me MiG-19. Tashmë kjo bazë shërben si një bazë

rezervë dhe përdoret për mbajtjen e avionëve që janë jo-operacionalë.

### Avionë të tërhequr nga shërbimi aktiv

MiG-15. Avioni MiG-15 ishte avioni i parë reaktiv (teorikisht turboreaktiv) në shërbim. Varianti trajnues u titullua MiG-15UTI. Ky lloj avioni ishte i pari reaktiv që fluturoj mbi qiellin e Shqipërisë. Avionët e parë ishin të prodhimit rus. Këta avionë fillimisht u bazuan në Kuçovë ku

u krijua edhe skuadrilja e parë reaktive titulluar "Peza".

MiG-17. Shumica e këtyre avionëve erdhën nga Kina falë prishjes së marrëdhënieve diplomatike me ish-Bashkimin Sovjetik. Forcat Ajrore Shqiptare ishin forca e vetme evropiane që dispononte avionë MiG-17 (dhe 19 e 21) të prodhura nga Kina. Shumica e këtyre avionëve u vend-bazuan në Kuçovë. Gjithashtu FARSH disponon versionin trajnues të MiG-17 (FT-5). I titulluar MiG-17UTI në shërbimin shqiptar.

MiG-19. Ky avion ishte avioni kryesor i FASH-së. I bazuar në tre baza ajrore: Kuçovë, Rinas dhe Gjadër ky avion ka luajtur një rol kryesor në këtë armë. Avionët e parë ishin të prodhimit sovjetik (MiG-19PM) të pajisur me radarë primitivë. Këto avionë më vonë u shkëmbyen me një sasi të madhe avionësh më pak të afërt të tipit MiG-19S (F-6S) të prodhimit kinez. Kinezët ishin të interesuar tek sistemi i radarit në MiG-19PM sepse në atë kohë Kina nuk dispononte teknologji të tillë.

MiG-21. Të transferuar nga Kina në fillim të viteve 70-të dhe të konsideruar si avionët më modernë të FASH-së, shumica e këtyre avionëve tashmë janë vënë në rezervë në bazën ajrore të Gjadrit. Nga 12 copë, 10 të tilla ekzistojnë sot. Një u shkatërrua në ngritje duke i marrë jetën edhe pilotit dhe avioni i dytë mendohet të jetë dëmtuar pasi doli nga pista.

**K**ëtë ditë Përfaqësues të Organizatës Botërore të Meteorologjisë (World Meteorological Organization) zhvilluan vizita dhe takime pune në disa institucione të vendit tonë, me qëllim evidentimin e progresit që ka bërë Shqipëria në fushën e meteorologjisë si dhe rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm. Në këtë kuadër, në datën 30 janar 2014, në ambientet e Komandës së Shërbimit Meteorologjik Ushtarak Tiranë, përfaqësuesi i Organizatës Botërore të Meteorologjisë për Zonën VI (Evropën) zoti Dimitri Ivanov dhe ekipi i tij, bënë një vizitë pune. Në takimin që u organizua në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet SHMU dhe OBM morën pjesë dhe përfaqësuesit e IGJEUM, Prof. Dr. Mitat Sanxhaku me detyrë drejtor i IGJEUM dhe Prof. As. Vangjel Mustaqi me detyrë zv/drejtor i IGJEUM. Në fillim të takimit, komandanti i SHMU nënkolonel Bardhyl Imeraj i njohu të pranishmit mbi historikun e shërbimit, gjendjen, rajonet e vendosjes së stacioneve meteorologjike, ecurinë, hapat dhe punën për ndryshimin e mentalitetit duke arritur standartet e përcaktuara nga OBM e ICAO, arritjet në realizimin e detyrave dhe misionin në interes të nevojave të Forcave të Armatosura dhe në kuadër të Emergjencave Civile. Si një arritje u theksua puna për përgatitjen profesionale e punonjësve duke bërë të mundur certifikimin 100% të personelit që punon në këtë Shërbim. Takimi u fokusua në progresin që ka bërë SHMU në fushën e meteorologjisë, duke theksuar se me ritme të shpejta do të ecet dhe për azhurnimet e reja duke patur përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që na jep Komandanti i Forcës Ajrore gjeneralbrigade Frederik Beltoja. Në zbatim të Ligjit për SHMU do të vijojë bashkëpunimi me institucionet homologe si brenda vendit ashtu dhe ato të huaja, sidomos me palën Italiane dhe



**Përfaqësues të lartë të Organizatës Botërore të Meteorologjisë vizitë pune në ambientet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, Tiranë**

## OBM, konsideratat më të larta për punën e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak

OBM, për shkëmbimin e të dhënave meteorologjike, me qëllim avancimin edhe më tej të punës në fushën e meteorologjisë, duke patur në konsideratë azhurnimet që do të përcaktohen nga Parlamenti i OBM. Gjatë bashkëbisedimit përfaqësuesi i OBM z. Dimitri Ivanov, shprehu konsideratat e larta për punën, performancën dhe arritjet e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak. Ky Shërbim-tha zoti Ivanov-i ka arritur këto

standarde falë dedikimit që ka Komandanti i këtij Shërbimi i cili me seriozitetin, njohuritë dhe zotërimin e shkencës së Meteorologjisë dhe punës së personelit që ai drejton, ka arritur ta kthejë këtë Shërbim në të njëjtin nivel me shërbimet simotra në Rajon. Falë punës së tij dhe specialistëve të këtij shërbimi tashmë të dhënat meteorologjike janë pjesë e sistemit global të transmetimit, duke e kthyer atë në një shërbim

efikas si në interes të Forcave të Armatosura ashtu dhe në interes të institucioneve kryesore të vendit e të Emergjencave Civile. Në fund të fjalës së tij z. Ivanov shprehu dëshirën për rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm të OBM me Shërbimin Meteorologjik Ushtarak, për zhvillimet e reja botërore në fushën e meteorologjisë. Delegacioni i OBM vizitoi dhe ambientet e punës. Në zyrën e parashikimit të motit, shefja e zyrës

Genta Stafa i njohu të pranishmit me punën që kryhet dhe standartet e larta që realizohen nga kjo zyrë për parashikimin e motit. Në ambientet e arkivit të SHMU zv/komandantja e këtij Shërbimi kapiten Rudina Zace i njohu përfaqësuesit e OBM-së me materialet arkivore që ruhen aty që nga dita e krijimit të Shërbimit Meteorologjik në vitin 1955 e në vazhdim, punën për ruajtjen e tyre si dhe masat që po realizohen nga personeli për dixhitalizimin e këtyre materialeve shumë të rëndësishme arkivore, të cilat ashtu siç u cilësuan edhe nga përfaqësuesit e OBM kanë një vlerë të paçmueshme për studime të ndryshme që mund të realizohen në fushën e meteorologjisë. Prof. Dr. Mitat Sanxhaku me detyrë dDrejtor i IGJEUM vlerësoj punën e bërë dhe nivelin e lartë të përgatitjes profesionale të specialistëve të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak të drejtuar nga komandanti nënkolonel Bardhyl Imeraj dhe shprehu gatishmërinë e plotë të institucionit që drejton për ta thelluar bashkëpunimin midis dy institucioneve në të ardhmen. Duke vlerësuar gjendjen aktuale si dhe nevojat e SHMU për pajisje e bazë materiale, në kuadër të modernizimit dhe bashkëpunimit, përfaqësuesit të OBM u shprehën të gatshëm për mbështetjen dhe kompletimin me instrumente dhe pajisje për disa nga stacionet meteorologjike të vendosura në rajonet të ndryshme të vendit tonë. Në fund të takimit për nder të vizitës së përfaqësuesve të OBM nga ana e Komandantit të SHMU u shtrua një koktej si dhe u bë një foto e përbashkët.

Përfaqësuesit e Organizatës Botërore të Meteorologjisë u larguan me mbresat dhe përshtypjet më të mira nga Shërbimi Meteorologjik Ushtarak.

**Përgatiti: Major (r) Aleksandër Cala**  
Shef i Sektorit të Aerologjisë në SHMU



# Për një qasje kombëtare në zhvillimin e Politikës së re të Mbrojtjes në fushën e Arsimimit të FA

KOLONEL (R) ZAIM KUÇI

**G**jerësia e fushës së veprimit të forcave tona ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, ka sjellë një natyrë tjetër në fjalës "ushtarak", e cila përbën një kompleksitet sjelljesh, nga më të thjeshtat deri në ato me nivel strategjik. Ajo prezantohet aq sa e thjeshtë në paraqitje po kaq e ndërlikuar dhe e zhërvjellët në veprim; aq dhe e rëndësishme dhe e domosdoshme për interesat kombëtare. Në një fushëbetjeje më shumë pranohet që fuqia e mendjes së një komandanti vlen më shumë se fuqia e zjarrit të një grupi ushtarak. Nëse luftërat e mëparshme kanë qenë më së shumti një "gjendje e fuqisë", tashmë, për herë e më tepër fushatat ushtarake po bëhen një "gjendje e mendjes". Gjithsesi, ndërsa situatat vijnë përherë dhe të komplikuar, që kupton se operacionet po ju largohen klisheve që prezantonin një shtab të kompletuar që kaligrafon bukur dhe njeh punën në harta, përdorimin e armëve, teknikat, taktikat dhe doktrinën e strategjisë ushtarake. Sot jemi në situata të tjera, më diplomatike, më të kamufluara, më me të panjohura dhe të papritura ku kërkohet që ushtaraket të jenë të pajisur dhe me njohuri të tjera që vijnë nga traditat, kultura që ka një komb, politika, ekonomia, diplomacia, etika, etj, të gjitha këto paraqesin vizionin ndryshe, që profesionisti ushtarak të ridimensionohet në lartësinë e mjedisit të krijuar. E konsideroj një sfidë përgatitjen e personelit në FA, edhe pse bëhet fjalë për ndryshimet e imponuara globaliste. Ato ruajnë, zhvillohen, modernizohen mbi një platformë edukimi për të përfutur virtytet e popullit shqiptar. Po cili është thelbi i kësaj sfide? Unë mendoj dhe mëshoj për atë sa më - Kombëtar. Nuk i përkas asaj kategorie njerëzish të cilët mendojnë: "flet bukur anglisht apo frëngjisht", "profesionist i zoti - fluturon bukur", apo "ushtarak i zoti", apo "specialist ushtarak": jam për dallimin e oficerit intelektual nga intelektualin ushtarak. Oficeri intelektual është oficeri që sjell një përmasë intelektuale gjithëformësh në përmbushjen e misionit të tij. Sot një ushtarak i zoti nuk formohet vetëm në mjediset ushtarake ose vetëm me lëndët ushtarake, por më gjerë. Ai duhet të fillojë, apo ka filluar specialitetin e ushtarakut me prejardhjen e formimit të tij, do ta kërkojë - më të mirën e elitës studentore universitare - , edhe pse sot është e parakohshme ta pranosh, por për një forcë ushtarake të limituar, për interesa kombëtare kjo duhet. Rrugët për të rekrutuar më të mirin janë të shumta, për mua mbetet: Motivimi. Duhet kuptuar se, operacionet si ato luftarake dhe paqeruajtëse nuk janë thjeshtë me natyrë ushtarake. Ato nuk janë kompleksitet armësh në një fushë betejje, nuk janë mësimje, apo mbrojtje, etj., në kuptimin klasik, tradicional të fjalës. Ato janë veprimtari politik-ushtarake, diplomatike, humanitare e më gjerë, që nënkupton një diversitet



kulturash që duhen të vektorizohen në interes të qëllimit. Në një operacion, të filluar apo jo, në se do t'i etiketojmë, skenaristët dhe regjisorët e këtyre veprimtarive, atëherë duhet të kuptojmë se nuk janë vetëm ushtarakët që plotësojnë skenaristin dhe regjisorin. Në një situatë të caktuar, në se kemi ushtarakët aktorë, ata duhet të njohin elementët e "regjisë" e të skenarit. Me fjalë të tjera operacionet nuk mund të kryhen me sukses nëse nuk integrohen e alternohen aktorë të ndryshëm të profesioneve të ndryshme. Do ta formuloja mendimin, e thënë ndryshe kjo do të thotë që civilët duhet të jenë "pak ushtarakë" dhe ushtarakët duhet të jenë "pak civilë". Të dyja opsionet janë aktorë dhe regjisorë, të dy palët duhen të plotësohen. Si ushtarak më intereson më shumë çështja e "civilizimit" të ushtarakëve, por sigurisht në FA duhet të integrohet jo çdo lloj personel civil, ai duhet të ketë dhe një formim sigurie (master për siguri, sidomos në struktura operationale/strategjike). Këto pleksen, marrin rrugëtimin në se kemi një strategji të qartë arsimimi që i bashkëlidhet rekrutimi. Për sa më lart, rregullatori i gjithçkaje në forcat e armatosura mbetet, sistemi arsimor që kemi zgjedhur për të na drejtuar, atë çka kemi instaluar dhe që duam të ndryshojmë për të arritur në destinacion. Nga eksperiencia personale them se formimi përgjatë parkurit tonë skolare, do dhe duhet të reflektohet, në atë që do të prodhohet dhe transmetojmë, qoftë kjo e mirë apo dhe e keqe në FA. Nisur nga praktikatat e deritanishme për formimin e personelit, funksionimin në praktikë të kësaj politike, me avantazhet dhe disavantazhet në ecurinë e deritanishme në Forcat tona, më duhet të sjell opinionin personal me disa opsione apo argumente për mundësinë e përfshirjes në politikën e re të pritshme të mbrojtjes, si më poshtë: Mendoj se,

stadi aktual i zhvillimit të FA plotëson kushtin që formimi i personelit në nivel taktik të zhvillohet tërësisht në institucionet e arsimimit në vendin tonë; kjo është kërkesë e domosdoshme për të rimarrë veçoritë e përgatitjes ushtarake kombëtare të brezave që do të formojnë të ardhmen në FA. Programi mësimor për përgatitjen e oficerëve të rinj nuk ka vështirësi përvetësimi. Ky nivel konsiderohet si marrja e elementëve fillestare taktik, gjë që nuk sjell nevojë për një ekspertizë më të kualifikuar, madje nuk ka dhe interesa financiare edhe në se ato do të jenë oferte bilaterale nga partnerët.

## Argumente

Forcat tona, tashmë e kanë kaluar këtë stad formimi të vullshëm jashtë vendit. Sot kërkohet si nevojë kualifikime afatshkurtra apo stërvitje të përbashkëta me vendet partnere. Për gjatë më shumë se 20 viteve studimi jashtë vendit, është krijuar eksperiencia e duhur për një formim cilësor shqiptar, gërshetuar kjo me eksperiencat e vendeve të tjera. Një oficer i sapo diplomuar jashtë shtetit (toger) nuk mund të njoh mirë, pa le t'i aplikojë tek vartësit e tij veçoritë e përgatitjes ushtarake kombëtare siç janë: edukimi kombëtar, traditat, njohje të forcave/mjeteve tona, njohja e terrenit si element kyç i zhvillimit të stërvitjeve etj. I sapodiplomuari jashtë shtetit nuk mund të drejtojë togën që në fillim të marrje së detyrës, atij do t'i duhet kohë për përshtatje, me terrenin në RSH dhe më gjerë, reflekse pune për logjistikën dhe armatimin tonë, me ato që ka marrë tradicionalisht në shtetin bartës. Politika e arsimimit të forcave tona jashtë shtetit të përqendrohet më tepër për personelin në specialitetet e veçanta, në shkollat e përzgjedhura të vendeve evropiane, që kupton arsimimin në shkollat e përbashkëta evropiane (anglisht).

Politika e arsimimit të vejë theksin që formimi i ardhshëm i personelit të bëhet

vetëm në gjuhën angleze.

Përftohet gjuha angleze, tashmë si gjuha e punës në FA;

Përftohet metodologjia e punës në grup;

Familjarizimi me oficerët e shteteve evropiane që do të punojnë së bashku në operacionet e pritshme (vendet e BE përbëjnë pothuajse NATO-n).

Formimi i deritanishëm i oficerëve tanë me "shumicë" në gjuhën greke, turke, italiane dhe më pak, ato franceze, gjermane, janë gjuhë që do të thojnë nuk i shërbejnë aq sa duhet misionit të përbashkët me vendet e NATOS-s, më tepër janë mundim dhe humbje kohë në përvetësimin e gjuhës angleze, përse jo dhe konfuzion praktikash për konsolidim e drejtim shtabesh, si dhe shpenzime buxhetore të panevojshme. Ato janë dhe kanë vlerë në se zgjidhen si opsion dytësor.

Procesi i formimit të personelit në FA është i domosdoshëm të bëhet vetëm me plane dhe programe perspektive afatgjatë për çdo specialitet dhe nivel grade. FA u duhet një plan minimalisht afatmesëm, konkret ku të parashikohen me shifra prurjet/daljet vjetore. Forcat e Armatosura nuk duhet të ecin më tej me modelin e "ofertave" bilaterale sikurse është vepruar deri më sot, pasi kemi sjellë edhe anomali në specialitetet, por me modelin e mirëstuduar të kërkesave që kanë Forcat e Armatosura. Planifikimi të përfshijë forcën në tërësi, edhe për individin në veçanti si e vetmja rrugë për avancimin apo jo në gradë të ushtarakëve. Forcat tona duhet të zhvillojnë kurse funksionale, kjo për njohjen dhe aftësimin më të mirë të oficerëve sipas detyrës organike. Mirëmenaxhimi i arsimimit të personelit do të jetë dhe një barrierë për avancimin në gradë të ushtarakëve. Nisur nga mungesa e nivelit të kërkuar i gjuhës angleze ka patur raste që një toger ka bërë edhe disa kurse, apo formime (shkollime të panevojshme) në nivel operacional dhe

kështu me radhë për gradat pasardhëse, kjo lë shteg për abuzime në përzgjedhjen e personelit. Përqendrimi i formimit të personelit tonë jashtë vendit në kurse afatshkurtra do të ishte një praktikë më pranë realitetit financiar për zhvillimin e forcave tona. Në varësi të kushteve ekonomike të zhvillimit të vendit kërkohen dhe rishikime dhe riformulime të kontratës midis studentit dhe MM. Marrëdhëniet bilaterale midis shteteve nuk duhet të kushtëzojnë arsimimin në FA. Praktika e deritanishme ka qenë edhe: pranim ofertash propozuar nga Atashetë e Mbrojtjes (spontane). Koha ka ardhur që formimi i personelit të FA të orientohet me një program afatgjatë drejt arsimimit evropian si më poshtë:

## Disa nga iniciativat e marra nga vendet e BE

Krijimi i Kolegjit të Mbrojtjes Europiane;

Përdorimi i përbashkët i kapaciteteve të stërvitjes për të gjitha vendet evropiane (programe të përbashkëta stërvitje);

Bashkëpunim në drejtim të grupit aeronaval dhe përgatitje e pilotëve luftarak (Advanced European Jet Pilot Training) në shkollën evropiane;

Bashkëpunim në drejtim të përgatitjes së efektivit për të fluturuar në standarde të njëjta në helikopter shumerolësh (shkolle evropiane për helikopterë); Shkolla e përbashkët franko-gjermane për përgatitjen e pilotëve të helikopterëve;

Propozohet një qendër e përhershme e formimit në drejtimin e krizave. Franca ka propozuar dhe një program evropian të shkëmbimit dhe të formimit për sigurinë dhe mbrojtjen (është në proces zhvillimi).

Një politike e përbashkët e formimit të personelit (për sigurinë dhe mbrojtjen) në shkollat evropiane do të integrojë më mirë veprimet ushtarake me ato të sigurisë në parametra juridik, sociologjik, lingvistik, politik, operacional etj.

## Eksperiencia e vendeve të tjera

Belgjika dhe Franca edhe pse janë shtete frankofone, përgatitjen e pilotëve të rinj dhe përdorimin luftarak të avionit e bëjnë së bashku, me instruktorë belgë dhe francezë në gjuhën angleze. Po kështu dhe për përgatitjen e oficerëve të rinj të forcave detare, Franca ka propozuar ndërtimin e një anije të re gjithëpërfshirë me shtetet e Evropës për të kryer praktikën detare së bashku me këto shtete në gjuhën angleze. Edhe pse gjuha frënge është gjuha e dytë e NATO-s dhe për BE është gjuha e punës, francezët përgatisin oficerët specialistë në kooperim me shtetet e tjerë në gjuhën angleze.

Gjerësia geografike e formimit në vende të ndryshme (në gjuhët e tjera) bëhet e planifikuar me kohë për personelin që do të shërbejnë në diplomaci apo shërbime të tjera speciale, kjo është eksperiencia e vendeve partnere.

Rritja e kapaciteteve intelektuale të personelit në Forcat e Armatosura, një detyrë e vështirë kombëtare, një kontribut real, një imazh për vendin, një diplomaci ushtarake e vlefshme për reputacion në interes të sigurisë të RSH.



## Kryetari i Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels, viziton BFS



Më datë 6 shkurt 2014, Kryetari i Komitetit Ushtarak në NATO, gjeneral Knud Bartels dhe ekipi që e shoqëronte bënë një vizitë në Batalionin e Forcave Speciale, strukturë e Forcave Tokësore. Gjeneral Knud Bartels i shoqëruar nga Komandanti i Forcave Detare, Gjeneral Brigade Qemal Shkurti u prit nga komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, i cili pasi ju uroj mirëseardhjen dhe falënderoi për vizitën, njohu Kryetarin e Komitetit Ushtarak në NATO dhe ekipin që e shoqëronte, shkurtimisht, me strukturën e Forcave Tokësore dhe njëkohësisht, theksoi se vizita në këtë batalion, është një vlerësim dhe respekt i veçantë për Komandën e Forcave Tokësore dhe Batalionin e Forcave Speciale. Aktiviteti vijoi me një brifing të shkurtër njohës dhe informues për Batalionin e Forcave Speciale nga kapiten Klinton Karaj, në lidhje me misionin, detyrat

që realizon, stërvitjet e zhvilluara, kompletimin me pajisje dhe kontributin e dhënë në misionet jashtë vendit, si në Bosnje-Hercegovinë, Irak, Çad dhe Afganistan, kontribute të cilat kanë marrë vlerësimet maksimale nga NATO. Më pas Batalioni i Forcave Speciale dhe Batalioni Komando, bënë një demonstrim për të pranishmit, në mënyrë dinjitoze, me stacione, si patrullim me mjete Max-Pro, qitje të llojeve të ndryshme (tranzicion, me precizion, qitje shpejtësie, me snajper) si dhe kontroll objekti, operacione në godinë, veprime në pritë, në kullën e alpinizmit, etj. Pas përfundimit të demonstrimit stërvitor, gjeneral Bartels, falënderoi trupat për performancën e treguar, shkallën e lartë të përgatitjes dhe për pjesëmarrjen në misione. Ai ju uroj suksese të mëtejshme në misionet e radhës.

Nënkolonel Shpëtim Hysa

# Ditar nga Batalioni i Dytë i Këmbësorisë së Motorizuar, prioritet i Forcave Tokësore

NGA MAJOR  
NEXHBEDIN BASHA

**P**rioritet nr.1, për trajnim, stërvitje e mbështetje me qëllim arritjen e nivelit të kërkuar operacional, krahas reparteve e nënreparteve të tjera të FA-së, është i planifikuar për vitin 2014, Batalioni Dytë i Këmbësorisë së Motorizuar, strukture vartëse e Forcave Tokësore. Komandanti i Batalionit, kolonel Ardian Bali, shprehet për gazetën "Ushtria", se "Më vjen mirë, që ky batalion, është projektuar repart prioritar në direktivën e Mbrojtjes të MM-së, Udhëzimet e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe komandantit të Forcave Tokësore. Për ne që kemi shërbyer prej disa vitesh këtu, është një ogur i mirë, se më në fund ideja e hedhur më parë, për repart operacional, lider dhe reagues, aset në dispozicion të FA-së shqiptare dhe të Aleancës, po merr rrugë për t'u konkretizuar. Këtë realitet të ri e shikojmë edhe në projektin e ardhur nga dikasteri për një kompani, sikurse është, kompania e parë e batalionit, si NRF, për të cilin ka nisur procesi i trajnimit me stërvitje në muajin janar 2014, në Hohenfels, në Gjermani dhe do të vijojë përgatitja sipas programit të hartuar me aktivitete të tjera në kuadër të FA-së dhe të NATO-s. Në vijim të punës për rritjen e operacionalitetit, këtë vit krahas stërvitjeve të tjera është planifikuar të zhvillohet stërvitja fushore "Biza 2014", ku do të bëhet edhe certifikimi i batalionit, një strukture, kjo e mbështetur ndër vite edhe nga anëtarët e Aleancës si Italia, SHBA, etj, për trajnim të personelit dhe për hedhje të idesë, repart lider i Forcave të Armatosura.

### Bashkëpunimi midis elementeve të luftimit dhe atyre shëndetësore

30 janari 2014, ishte një ditë e zakonshme stërvitje. Në zbatim të Direktivës së MM, udhëzimeve të SHSHP të FA dhe komandantit të FT, për stërvitjen 2014, në rajonin "Luftëtari i Çeliktë" të garnizonit Zall-Herr qendër, Batalioni i Dytë i Këmbësorisë së kompanisë e tretë "Puma" dhe qendrën shëndetësore, zhvilloi stërvitjen treguese,



me temë: "Veprimet e kompanisë për sigurimin e bazës". Qëllimi i kësaj stërvitje ishte integrimi dhe ndërveprueshmëria ndërmjet kompanisë së luftimit dhe qendrës shëndetësore të b2k për dhënien e ndihmës shëndetësore Rol-I. Kjo stërvitje u ndoq nga komandanti i Forcave Tokësore dhe anëtarët e shtabit të FT. Komandanti i batalionit, kolonel Ardian Bali njohu të pranishmit me temën dhe qëllimin e stërvitjes, e cila në fokus kishte elementë të paqeruajtjes, për ruajtjen, kontrollin dhe sigurimin e bazës dhe ndërveprimin e kompanisë me qendrën shëndetësore, si element mbështetës. Jemi në hyrje të poligonit "Luftëtari i Çeliktë". Në sektorin e kontrollit të rajonit të stërvitjes, të ngritur me të gjithë elementet takojmë tetar Ermal Hate dhe nëntetar Dashmir Prenga, ata kanë për detyrë kontrollin e hyrjes

të personelit në bazën e improvizuar në këtë rajon stërvitor. Sapo jepet sinjali i fillimit të stërvitjes, në postbllok shfaqet një person civil, për të cilin ndiqen të gjitha procedurat standarde të kontrollit. Tetar Hate, thotë se më këto procedura kontrolli jemi familjarizuar, pasi e kemi kryer realisht në bazën ushtarake në Herat, Afganistan, kur kryenim detyra si "Force Protection", përkrah trupave italiane. Gjatë kontrollit verifikojmë me imtësi çdo element, pavarësisht stërvitjes rutinë. Detyra jonë, pohon ai, konsiston në kryerjen e veprimeve njësoj si të ishish në një bazë ushtarake. Pas kësaj vijnë situata të tjera të kontrollit të mjeteve me pajisjet, të cilat janë të ngjashme me procedurat standarde si të misioneve. Të gjitha veprimet dhe situatat u ndoqën nga komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku dhe anëtarët e shtabit të FT-së.

Kapiten Hysni Ymeraj, komandant i kompanisë "Puma" me eksperiencë në misione, shpjegon se tema e stërvitjes është: "Veprimet e kompanisë për sigurimin e bazës" dhe me detaje sqaron për skenarët dhe stacionet stërvitore. Ndonjëherë e ndërpret fjalën dhe komunikimi vijon në radio. Ajo që bie në sy është komunikimi standard, duke zbatuar me përpikëri kodet e komunikimit, po ashtu edhe mënyra e vendosjes të segmenteve, të lëvizjes së personelit, vendosjes së qendrës shëndetësore, të kontrollit të automjeteve, të elementeve të ruajtjes dhe sigurisë, të vendstrehimit, etj. Pas stërvitjes rutinë "prishi" disi rregullin një sirenë që lajmëronte se nga jugu i bazës ka goditje me artileri. Situata bëhet më interesante kur kërkohet të vihen në lëvizje trupa të reagimit shpejtë e struktura mbështetëse. Nga vendkomanda vjen urdhri se për t'u

ardhur në ndihmë të dëmtuarve, pra të plagosurve nga goditja me artileri, situata këto të improvizuara, duhet të aktivizohen elementet shëndetësore. Komandanti i Qendrës Shëndetësore, kapiten Olsi Tahiri, një të pranishmit me misionin që ka kjo qendër dhe detyrat që kryen. Ai me të marrë urdhrin nga vendkomanda me personelin shëndetësor dhe ambulancat që gjenden në gatishmëri lëviz për në rajonin ku duhet të jepet ndihma. Rreshteri Fatos Kuçi me personelin shëndetësor bashkërendojnë detyrat me efektivin e ruajtjes e sigurisë në bazë dhe sipas shkallës së dëmtimit japin ndihmën shëndetësore. Komandanti batalionit, thekson se personeli i qendrës shëndetësore, përbëhet nga infermierë me eksperiencë në këtë fushë, 12 veta prej të cilës me arsim të lartë. Ata, shprehet rreshter Kuçi, kanë eksperiencën e duhur dhe janë përbalhur edhe në situata reale, sikurse ka qenë situata në stërvitjen "Biza 2011", kur një fshatar e kafshoi gjarpri dhe ju dha ndihma e parë shëndetësore nga personeli i kësaj qendre, deri sa erdhi helikopteri. Gjatë stërvitjes të drejtuar me profesionalizëm nga komandanti i kompanisë, kapiten Hysni Ymeraj, pjesëmarrësit u njohën me skenarin, trupat pjesëmarrëse dhe incidentet e parashikuara. Në skenarin e stërvitjes u realizuan situata të natyrës paqeruajtëse; si kontrolli i personelit civil dhe automjeteve në hyrje të bazës, veprimet e efektivit gjatë goditjes me artileri, gjatë sulmit terrorist, dhënia e ndihmës së parë nga personeli i qendrës shëndetësore të batalionit etj, veprime të cilat u kryen sipas procedurave standarde. Në përfundim të stërvitjes, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, falenderoi efektivin dhe drejtuesit e stërvitjes për performancën e treguar. "Ajo që vë re, theksoi gjeneral Dushku, është se ju në përgjithësi e keni kuptuar konceptin bazë të stërvitjes për misionet e mbështetjes së paqes, jeni përbalhur me vështirësitë pasi keni qenë në misione të tilla si në Bosnje-Hercegovinë, në Irak apo Afganistan. Por, kërkesat e sotme shtrojnë para jush që secili të njohë mirë detyrën dhe të dijë si të veprojë kur gjendet përballë të papriturave, ndaj duhet të dini të vepronit edhe për situata më të vështira dhe në kushtet e stresit psikologjik... Kjo, theksoi gjenerali,





”

*“Ajo që vë re, theksoi gjeneral Dushku, është se ju në përgjithësi e keni kuptuar konceptin bazë të stërvitjes për misionet e mbështetjes së paqes, jeni përballur me vështirësitë pasi keni qenë në misione të tilla si në Bosnje-Hercegovinë, në Irak apo Afganistan.*”

realizohet nëse ju gjatë gjithë procesit stërvitor futeni në detaje të disiplinës profesionale, kur nënoficeri luan rolin e tij si drejtues, në çdo detaj të stërvitjes, duke mos nënvleftësuar edhe gjërat më të vogla. Eksperiencia dhe mësimet e nxjerra nga stërvitjet dhe misionet e kryera, theksoi ai, duhet t’ju shërbejnë si model orientues i ndërtimit të punës në të ardhmen”. Në të njëjtën kohë kërkoi që krahas stërvitjeve me karakter paqeruajtës të fokusohemi në zhvillimin e stërvitjeve në kushte sa më reale.

#### **Repart, me eksperiencë misionesh në mbështetje të paqes**

Efektivat e këtij batalioni janë pjesëmarrës në shumë misione paqeruajtëse në botë si, Bosnje-Hercegovinë, në Kabul dhe Herat, Afganistan. Po ashtu dhe në stërvitje të përbashkëta dypalëshe e shumëpalëshe në New Jersey të SHBA, në Gjermani etj. Në vitin e kaluar krahas stërvitjeve kompaktësuese, 72 orëshe “Kobra dhe Dragon-2013”, stërvitjes fushore, “Biza 2013”, “Combrain Patrol-13”, etj, ky batalion mori pjesë edhe në stërvitjen “Joint Reaction 2013”, në kuadër të Inicativës së Kartës së Adriatikut (A-5), me pjesëmarrje trupash nga Maqedonia, Mali Zi, Shqipëria dhe Forca e Sigurisë së Kosovës me skenarë të kërkim-shpëtimit në det dhe në tokë, duke përdorur procedura standarde. Nënrepartet pjesëmarrëse në këto aktivitete stërvitore dhe në misione të mbështetjes së paqes kanë marrë vlerësime pozitive nga drejtuesit e stërvitjes, ushtarakë të lartë amerikanë dhe të Aleancës. Për nivelin operacional në këtë repart janë bërë certifikime të ndryshme nga ekipe vlerësuese të NATO-s, vlerësime të cilat kanë nxitur efektivat të rrisin

## Stërvitja në bazën Hohenfels, rritje profesionalizmi

Ai që ka shërbyer dhe shërben në Batalionin e Dytë të Këmbësorisë, në përpjekjet që po bëhen për konturimin e tij dhe këmbënguljen e drejtuesve të lartë të MM-së e FA-së, për ta bërë njësi elitare, operacionale dhe të ndërveprueshme, shpreson. Kjo shpresë buron edhe nga fakti se hapi i parë është hedhur, fillimisht me kompaninë e parë të luftimit, për të cilën sipas edhe udhëzimeve të ardhura nga dikasteri ka nisur të konturohet projekti, kompani NRF, jo vetëm për trajnim, por edhe modernizim. Efektivit i kësaj kompanie dhe një togë e batalionit të Policisë Ushtarake, me komandant i kontingjentit për dy nënrepartet major Gentjan Karaj, shef i operacioneve të këtij batalioni, sapo është kthyer nga stërvitja në bazën JMRS Hohenfels Gjermani. Kompania e parë, e njohur si “Zemër Luanët” e drejtuar nga kapiten Behar Kamberi nga data 10 janar deri me datë 3 Shkurt 2014, krahas trajnimit zhvilluam edhe një stërvitje të përbashkët me trupa, në kuadër të bashkëpunimit NATO-Shqipëri. Efektivat pjesëmarrës mbërritën në bazën JMRS Hohenfels Gjermani pasditën e datës 12 janar 2014. Pas një udhëtimi të gjatë, i cili pati ngarkesën e vet pasi transporti i trupave shqiptare u bë në rrugë tokësore dhe dy nënrepartet e prisnin detyra dhe stërvitje të lodhshme me pjesëtarë të shteteve të ndryshme të NATO-s dhe PFP-së. Stërvitja, thotë kapiten Kamberi, kishte për qëllim aftësimin e trupave për kryerjen e operacioneve për mbështetjen e paqes dhe sidomos për situatat në Kosovë. Ajo u fokusua në këto tema kryesore: rrethim - kontroll, shpërndarje turme nën efektin e lëndëve djegëse FIRE/PHOBIA, kontroll mbi menaxhimin e kufijve, liria e lëvizjes të veprimit në rrugë, MEDEVAC UXO me helikopter, zbritje nga helikopteri, sigurim zone, patrullim rikonicioni dhe patrullim normal, njohja e armatimit amerikan M16, pikë kontrolli, rikonicion, krehje zone, reagim ndaj lëndëve shpërthyes,



standartet në të gjitha disiplinat. Ky batalion ku drejtimi me mision është prioritet i komandantit të batalionit, kolonel Bali, i cili ka një eksperiencë të mirë si drejtues repartit dhe në shtab të forcave, ka arritur të koordinojë më së miri drejtimin e trupave në interes të plotësimin të detyrave dhe arrijtes së objektivave që ka repartit që ai drejton. Përgatitja dhe trajnimet si për drejtuesit e niveleve të ndryshme, ashtu dhe për trupën, kanë synuar në kohezionin e grupit dhe kompaktësimin e trupës deri nivel kompanie e batalioni. Arrijtes së këtij objekti shumë të rëndësishëm i kanë shërbyer rezultatet e larta të trajnimeve individuale dhe kolektive më të gjithë efektivat, kjo është realizuar krvesisht nëpërmjet trainimeve nga

ekspertë italianë dhe amerikanë për fusha të caktuara si: për minat shpërthyes, për transportuesin e blinduar, për shtabin dhe liderin luftarak etj. Një risi për shtabin dhe komandantët e nënreparteve të këtij batalioni ishte edhe stërvitja planizuese “Manza 2013”, zhvilluar për here të parë në Qendrën e Simulimit të FA, për procesin e vendimmarrjes etj. Në shtab dhe nënreparte pjesa më e madhe e efektivit ka qenë pjesëmarrëse në shumë misione dhe të trajnuar nga ekspertë të ushtrive të NATO-s, anëtarë të së cilës jemi ne. Ky angazhim dhe kjo eksperiencë, e bëjnë këtë batalion që të vazhdojë rrugën e suksesshme për t’u bërë i ndërveprueshëm me aleatët e tierë të NATO-s.

goditjes me napalm etj. Komandanti i kontingjentit major Gentian Karaj, shprehet se komanda e bazës, vlerësoi aftësitë e drejtuesve të togave, nivelin i lartë të stërvitjes, koordinimin me oraret që në fillimin e stërvitjes në orën 05 të mëngjesit e deri në orët e vona të mbrëmjes, si dhe veprimet e sakta gjatë stërvitjes duke përballuar të ftohtin e maleve të mbuluara me dëborë të Hohenfels. Një risi e kësaj stërvitje, shprehet ai, ishte hapësira që u lihej trupave tona për të improvizuar veprimet taktike në terren sipas komandanteve të grupeve mësimore. Kjo stërvitje ishte një eksperiencë më shumë dhe një standard i ri në ushtrimet stërvitore, të kësaj kompanie, pasi pati edhe efektiva brenda saj që nuk ishin trajnuar më parë në këtë bazë dhe për ta ishte një vlerë e shtuar. Stërvitja nga data 13-22.01.2014 u zhvillua në ambientet e bazës, njohuri teorike dhe veprime praktike. Stërvitja treguese në kushte fushimi e emërtua “COOPPLAN MINOR” u zhvillua nga data 22-31.01.2014 nën efektin e kushteve të vështira atmosferike në malet e Hohenfels. Ajo u shoqërua me situata patrullimi si ditën dhe natën. Në këtë stërvitje u angazhua i gjithë batalioni i bazës. Efektivit shqiptar i ndarë në toga, kreu detyra të rëndësishme, shpërndarje turmash nën efektin e lëndëve shpërthyes dhe napalmit, improvizuar me situatat

në Kosovë, Mitrovicë dhe një togë sigurimi në check point, roli i së cilës ishte përfaqësues. Stërvitja u karakterizua nga një motivim i lartë dhe përgjegjësi për të arritur të gjitha objektivat e caktuara. Synimi i drejtuesve të kompanisë që u vu në veprim, ishte drejtimi me mision, çka ishte si prioritar, komandimi dhe drejtimi i trupave në mënyrë të pavarur. Ajo çka e bëri më të rëndësishme këtë stërvitje, pohon komandanti i kompanisë “Zemër Luanët”, ishin vlerësimet e larta për trupat pjesëmarrëse në stërvitje, nga komandanti i bazës JMRC n/ kolonel Coggill. Në ceremoninë e mbylljes së stërvitjes n/kolonel Coggill, pasi vlerësoj nivelin e përgatitje të trupave shqiptare, në mbyllje i dorëzoi, ku shkruhej: “Përfundoi me sukses të plotë stërvitjen e përbashkët me trupat e NATO-s”.

Viti 2014 si për të gjithë FA, për Batalionin e Dytë të Këmbësorisë, ka vendosur objektiva të reja për stërvitjen, trajnimin dhe vlerësimin e saj, detyra të cilat po ndiqen më përkushtim dhe me përparësi, na thotë shefi i shtabit të këtij batalioni, major Sokol Gjyriçi, i cili nuk fsheh mundin, djersën, krenarinë, sakrificën e drejtuesve dhe ushtarëve profesionistë, me të cilët ka bërë të mundur kapërcimin e vështirësive duke realizuar detyrat e arritura dhe të gjithë objektivat në çdo zë. Ky batalion punon e stërvitet me profesionalizëm të plotë për realizimin e qitjeve me lloje dhe kalibre të ndryshme armësh, zhvillon tema për mësimin, mbrojtjen, stërvitjen në qendra të banuara, goditje

objekti, kalim pengesave ujore, stërvitje në zona të pyllëzuara, stërvitje malore, stërvitje për emergjencat civile, stërvitje rreshtore, marshime 25 km etj. Në këtë batalion të gjithë efektivat drejtues në çdo harkë përdorin gjuhën operacionale, gjuhën angleze, për të cilën falë mbështetjes së Zyrës së ODC, SHBA në Shqipëri u bë e mundur ngritja e një laboratorit model të gjuhës angleze, ku si gjatë vitit të kaluar dhe këtë vit po shfrytëzohet me kapacitet, për mësimin e gjuhës angleze, niveli i parë. Ky batalion në periudhën 22-27 qershor 2014, do të certifikohet në rajonin e poligonit Kombëtar të Bizës, sipas sistemit Creval të NATO-s, proces i cili ka nisur me stërvitje intensive nga të gjitha nënrepartet vartëse.



# UÇK

## Kosova dhe Ushtria e saj Çlirimtare

*Dëshmia e gjeneralit Kudusi Lama, qasje e përjetuar në vijën e parë të atij konflikti ushtarako-politik*

Nga Azem PARLLAKU

**L**ibri me titullin shumë domethënës “Kosova dhe Ushtria Çlirimtare”, i gjeneralit Kudusi Lama, përmban një lëndë të pasur në shumë aspekte të historisë dhe aktualitetit, ndaj dhe shërben si një qasje interesante, ku inspirimet janë marrë nga ngjarjet në Kosovën e viteve 1998-1999, ngjarje të cilat autori i ka përjetuar aty në vijën e parë të atij konflikti ushtarako-politik. Ky libër nuk është gjë tjetër veçse një aureolë pikëvështrimesh të qëmtuara mbi të vërtetat historike dhe mbi terrenin e një Luftë Çlirimtare në kohët moderne në këtë pjesë të Europës. Libri hapet me një parathënie brilante të mjekut dhe politikanit Profesor Doktor Sabit Brokaj, ndërsa në fund qëndron “si qershi mbi tortë”, një mbyllje e detyruar që gjeneral Lama, e ka bërë në formën e debatit publik me gjeneralin Wesley K. Clark, komandant Suprem i NATO-s, në periudhën e luftës në Kosovë, në lidhje me konsideratat rreth librit të gjeneralit Clark “Të bësh luftë moderne”. Materialet që prezantohen në këtë libër janë vështrime të historike, komente, kujtime, konsiderata, e realitete, ku autori ruan ekuilibrin e tij politik, ushtarak, moral dhe intelektual, duke na dhënë mundësinë që ta kuptojmë dhe analizojmë rolin e madh Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në atë periudhë të zhvillimeve komplekse politike, ushtarake e diplomatike në të cilat ishin involvuar faktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Veç kësaj përmes këtij libri autori Kudusi Lama, ndërton një komunikim të veçantë me lexuesin e tij, duke i dhënë mundësi atij të shohë në mënyrë të plotë idetë dhe filozofinë e tij. Profili i lartë si ushtarak, po kaq dhe intelekti i gjeneralit Lama, e kanë ndihmuar atë, për të pasuruar bibliotekën tonë me një libër të çmuar historik, nga ku referencat do të jenë përherë nxitje për shkrime dëshmuese të bashkëkohësve e studiuesve të tjerë, po kaq dhe interpretime dhe polemika të vlefshme. Nëpërmjet këtij libri autori ka bërë një përpjekje dinjitoze, për të na dhënë të plota informacionet e duhura, mbi zhvillimin e ngjarjeve kryesisht të prag-luftës, të luftës, e pasluftës në Kosovë. Analizat e gjeneralit Lama për këto ngjarje, si dhe për ato të perspek-

### Duke kujtuar gjurmën e lavdishme të UÇK-së, kujtojmë pjesën më të nderuar të kombit

Albert Hitoallaj

**N**ë datën 31 janar u mbushën 17 vjet nga rënia heroike e dëshmorëve të kombit, që dhanë jetën për pavarësinë e Kosovës, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, të cilët u vranë në Pestovë të Vushtrrisë, në një pritë të organizuar nga regjimi serb. Ata ishin pushka e parë e Lirisë, dëshmorët e parë të çështjes së lartë të çlirimit të Kosovës, ishin simboli i gjakut të dhënë për kombin. Heronj si Zahir Pajaziti, një prej pionierëve të themelimit të UÇK-së, do të mbesin përjetë në kujtesën historike shqiptare, si për vlerat e tyre edhe për guximin e treguar. Mëngjesin e datës 31 janar, kryeministri Thaçi, kryetari i Komunitetit të Prishtinës, Shpend Ahmeti, lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurtin dhe persona të tjerë të shumtë, ishin për nderim tek shtatorja e Zahir Pajazitit në sheshin e Prishtinës, që mban po të njëjtin emër.

“Sot u mbushën 17 vite të rënies heroike të komandantëve të parë të UÇK-së, të Zahirit, Edmondit, Hakifit, të bashkëluftëtarëve të mi dhe shumë bashkëluftëtarëve të UÇK-së. 17 vite të rënies së madhe për t'u ngritur të gjithë qytetarët e Kosovës në betejën për liri dhe pavarësi. Sot, këta tre komandantë të UÇK-së, por edhe gjithë dëshmorët e lirisë, i nderon dhe i kujton shteti i Kosovës, i nderon dhe i kujton kombi shqiptar. Kështu që sot, të gjithë ndihemi krenar për sakrificën e tyre, por në të njëjtën kohë çdo nderim i yni pranë lapidarëve të tyre është edhe marrje e energjive të reja për punë edhe më të mirë, por në të njëjtën kohë edhe për të vazhduar implementimin e vizionit tonë për t'u integruar sa më shpejtë si shtet i pavarur dhe sovran në NATO dhe Bashkimin Evropian” – është shprehur Kryeministri Thaçi.



tivës, janë me shumë vlerë dhe impresionuese për çdo shqiptar, qoftë ky ushtarak, qoftë politikan, apo qytetar ndryshe. Këto analiza paraqiten thellësisht në përmbajtje dhe fakte, po kështu vërehet dhe qëndrimi kritik dhe këshillues i autorit, i cili në qendër të universit të vet, ka vendosur idealet tona kombëtare. Përmes plazmimit të ngjarjeve dhe karaktereve, del në pah individualiteti i papërsëritshëm shq-

iptar. Pikërisht kështu vjen e ravijëzohet para lexuesit teknologjia e plazmimit siç e ka thënë shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare se: “Ideja e lirisë sa ç’është e natyrshme te popujt, aq përbën një katastrofë me mungesën e saj”. Në të gjithë analizën e tij autorin e ka shqetësuar dukshëm një fakt, që gjithsesi ka qenë e vërteta për t'u rrëfyer si e tillë. Ka shumë gjasë që gjeneral Lama i cili është ndodhur në qendrën



Gjithashtu, edhe Albin Kurti, lideri i Vetëvendosjes, do të shprehej se historia e kombit nuk do të ishte e plotë pa heronjtë, dëshmorët e martirët e vendit. Kurti gjatë fjalës së tij, e ka krahasuar profilin heroik të Pajazitit me atë të figurave heroike të kombit shqiptar si Avni Rustemi dhe Vojo Kushi. “Historia e kombit shqiptar, është para se gjithash e mbi të gjitha historia e heronjve dëshmorëve dhe martirëve tonë. Po ja hoqe historisë, heronjtë, dëshmorët dhe martirët, atëherë pak-çka mbetet aty. Ne jemi aty sot këtu ku jemi duke ju falënderuar para se gjithash heronjve si Zahir Pajaziti të cilët kontribuuan aq shumë për të dhënë gjithçka. Prandaj, sot kur ne në 17 vjetorin e rënies së tij, e kujtojmë Zahirin me shokë, sigurisht që, i përkujtojmë edhe heronjtë dhe dëshmorët e martirët e tjerë të kombit, ku Zahir Pajaziti ishte shumë i veçantë sepse ai i përkiste plejadës së heronjve siç ishin Avni Rustemi e Vojo Kushi” – u shpreh Kurti. Momenti në të cilin UÇK doli në pah, ishte moment historik, pasi ai moment shënoi zgjimin kombëtar të Kosovës, thyerjen e heshtjes së nënshtrimit, ashtu si vullkanet e fjetur të cilët demonstrojnë haptas se ç’fuqi kanë. Ishte historik ky zgjim, pasi theu edhe vetë psikologjinë e shumë shqiptarëve të Kosovës të cilët mendonin se forma e armatosur e kryengritjes ishte e gabuar. Por rezultoi e kundërta: UÇK u shfaq si një profet në udhën e Çlirimit. Ajo, nëpërmjet bijve më të mirë të kombit, të cilët mishëronin vlerat më të larta njerëzore, gdhendi lirinë e Kosovës. Kjo ishte koha kur ata njerëz me shpirta të fuqishëm, si Zahir Pajaziti, të ushqyer nga patriotizmi, filluan të kryenin aksionet e para çlirimtare kundër shtypjes mizore serbe. Lëvizja e tyre i dha shtysë të pabesueshme ri-ngritjes shqiptare duke e shndërruar atë në një luftë çlirimtare që aspironte lirinë e vendit e të kombit.

dhe në vijën e parë të ngjarjeve ushtarako-politike gjatë konfliktit në Kosovë, të ketë patur parasysh një frazë të njohur të Uinston Çerçillit, për popujt që prodhonin më shumë se ç’duhet histori, dëshmonte në mos frikë të fshehtë, një bezdisje të herëpashershme prej historisë. Dhe këtë e ka bërë për dy arsye; E para siç vërehet në këtë libër, ka të bëjë me atë çfarë historiografia serbe, ka trajtuar dhe e

trajton Kosovën. Për këtë nëpërmjet këtij libri na vijnë fakte të cilat nuk janë ditur siç duhet deri më sot, e siç duket historianët serb kanë prodhuar aq shumë histori dhe të pavërteta, sa që në fundshekullin e XX, mbetën të befashuar qytetërimet botërore të zhvilluara. Ndërsa e dyta ka të bëjë me shumë të pavërteta, të cilat promovohen nga pseudo-protagonistë të konfliktit ushtarako-politik në Kosovë. Mjafton t'u hedhësh një sy të përditshmeve të printuara të Prishtinës dhe Tiranës, e të gjesh plot histori të shitura nga “trimëritë pas lufte”, komandantët pa ushtarë, të cilët nuk po i shërbejnë aspak të vërtetave, e fatkeqësisht shumë prej ngjarjeve të rrëfyera janë shndërruar në ngjarje të vërteta. Me të drejtë, një polemizues mund dhe të shtrojë pyetjen; Përse gjeneral Lama, e ka glorifikuar kaq shumë rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?! Përgjigjen natyrshëm e gjen përsëri në analizë të fakteve që gjenerali, ka shkruar në librin e tij. Sigurisht që rreth rolit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në luftën për lirinë dhe pavarësinë e kësaj cope Shqipërie, janë bërë dhe do të bëhen shumë komente, qoftë nga shqiptarët e Shqipërisë natyrale, qoftë dhe nga të asaj shtetërore. Në thelb sërish mbetet e vërteta të cilën gjeneral Lama e ka trajtuar nga shumë plane dhe këndvështrime, ku mbetet i pandryshuar fakti se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e kreu detyrën e saj, duke mbetur kështu përjetësisht krenare për veprën madhore. Ajo e realizoi misionin për të cilin u krijua. E lindur në një terren të pushtuar, ajo erdhi si një freski kombëtare, për të bërë protestën e madhe shqiptare për liri. Në këndvështrimin e tij, autori e ka lidhur ngushtësisht rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me frymëzimin dhe përvojën e patriotëve të tillë si: Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Haxhi Zeka, Idriz Seferi, Azem Galica, Shaban Polluzha, Jusuf Gërvalla, Adem Jashari, etj. Të gjithë këta bashkëpatriotë, kanë promovuar një strategji politiko-ushtarake për çlirimin e Kosovës, teksa Ushtria Çlirimtare e Kosovës e ndërjegjësoi dukshëm popullin e Kosovës për një luftë të armatosur kundër pushtimit serb, si e vetmja rrugë për të fituar lirinë. Gjithashtu një rol të rëndësishëm sipas autorit ka dhe fuqia magjike e fjalës, mirëkuptimit dhe





dialogut. Se sa e rëndësishme është kjo mjafton që autori na kujton se; “Fjala krijoi njeriun, fjala ndërtoi shoqërinë njerëzore, fjala krijoi zhvillimin, fjala krijoi kulturën, fjala krijoi historinë, pra fjala është arma më e fuqishme e shoqërisë njerëzore, e në Kosovë fjala dhe dialogu duhet të jetë në plan të parë”. Siç vëren pikëshikimi i analizave dhe ngjarjeve, gjeneral Lama e ka parë gjithçka në fokusin e një ushtaraku profesionist, e vështrimit të tij nuk i ka shpëtuar asgjë. Ai ka patur mundësinë të shohë dhe vlerësojë qëndrimet e secilit protagonist të fushëbetesës, ndaj dhe shkruan me dashuri dhe dhembshuri emocionuese për të gjithë ata djem dhe vajza, që luftuan për një kauzë, siç ishte çlirimi i Kosovës. “Ishin këta djem dhe vajza që ngritën dinjitetin e popullit, ishin ata të rënë që çimentuan themelet e pavarësisë, e populli që jeton lirinë e ka obligim t’u njohë lavdinë”, kështu citon autori më shumë se njëherë. Dhe të

gjithë këtë e shkruan, jo për të bërë të pazëvendësueshëm rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por për të na kujtuar se idetë mund të jenë të ndryshme, pikëpamjet mund të jenë shumëngjyrëshe, e se programet politike janë po të ndryshme, ndërsa heronjtë dhe ideali i tyre janë të patjetërsueshëm. Misioni historik kërkonte bartësit e tij, e ku veç tjetër se djemtë dhe vajzat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të shprehej gatishmëria për sakrificë. Filozofi gjerman Schopenhauer na kujton se; “Kush e shikon gjithçka në një dritë të errët dhe është i përgatitur për më të keqen, ai gabon më rrallë në parashikimet e veta, sesa njeriu që e shikon jetën si fushë me lule në ngjyrë trëndafili”. E sollëm në vëmendje filozofin Schopenhauer, për të kujtuar sesa e rëndësishme ishte sipërmarrja e politikës aktive e cila me kalimin e kohës u kthye në rezistencë të armatosur, në raport me politikën paqësore, e cila edhe pse kishte qëllim të mirë nuk



mundi dot të jetë aktive sa ç’duhej. Në parathënie të këtij libri politikani Sabit Brokaj na kujton një thënie të Frederikut të Madh; se “Politika pa armë është si muzika pa vegla”, ç’ka u bë me dije se mossuksesi i zgjidhjes së çështjes së Kosovës në mënyrë paqësore, solli si domosdoshmëri një proces të vrullshëm për çlirimin e saj me fillimin e veprimeve luftarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në aspektin ushtarak gjeneral Lama evidenton rolin mbrojtës të kësaj ushtrie, përballë të cilës ishte një tjetër ushtri pushtuese me forca të shumta ushtarako-policore. Në dritën e fakteve, të vërtetave të patjetërsueshme autori shpjegon kohezionin përbrenda ushtrisë në fjalë, midis asaj dhe faktorit politik, midis të dyve dhe rolit mbarëshqiptar, midis këtij të fundit dhe politikës ndërkombëtare, ku kjo e fundit ka një rol të padiskutueshëm me angazhimin e NATO-s, për zgjidhjen e konfliktit të armatosur në Kosovë. Është mjaft i guximshëm dhe domethënës fakti, që në këtë libër merren në analizë pothuaj të gjithë faktorët me ndikim në çështje të tilla të mëdha. Historia, diplomacia, popullsia, ekonomia, politika, ushtria, kultura, e deri tek konspiracioni shqyrtohen në mënyrë bindëse dhe rrjedhshëm në kohë e hapësirë. Që në titull, është e kuptueshme se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, kuotohet në lartësinë e vlerave, si pararojë e ri-ngritjes kombëtare. E në optikën e gjeneralit, ishte kjo ushtri ajo që e ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës, por dhe të shumë vlera të shqiptarëve që Europa ose nuk i dinte, ose i kishte harruar qëllimisht. Në atë kohë drejtuesi i njësisë më të madhe ushtarake e cila kishte nën përgjegjësi zonën verilindore të vendit, gjeneral Lama siç dhe e ka shprehur, ka patur fatin ta njohë dhe të bashkëpunojë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, që prej lindjes së saj, në të gjitha etapat deri në futjen

fitimtare në Prishtinë dhe qytetet tjera të Kosovës. Autori na jep një tablo të qartë për të gjitha njësitë e kësaj force ushtarake, ndërkohë portretizon në karakteristika dhe rol të gjithë drejtuesit ushtarakë dhe politik të saj. Ideatorët, politikanët, organizatorët, drejtuesit ushtarakë, dallohen jo vetëm si patriotë të përkushtuar, por dhe vizionarë, të disiplinuar dhe të përkushtuar për të përmushur misionin fisnik të marrë përsipër. Se sa e suksesshme rezultoi një gjë e tillë, autori e përshkruan në të gjitha etapat e zhvillimit të betejave. Pjekuria për të organizuar një veprimtari të tillë, ku parashikoheshin në detaje të hollësishme detyrat e luftës dhe mbështetjes së popullsisë, koordinimi me aleatët, dëshmon qartësisht pjekurinë politiko-ushtarake të protagonistëve të kohës në fjalë. Shumë nga përcaktimet që gjenerali ka bërë në librin e tij, janë dëshmuar si të vërteta të thëna nga një profil idealist si i atij. Kështu ai shpesh e ngre zërin kritik ndaj politikës, ndaj pengesve të luftës, madje duke u bërë dhe zë kritik për analizat e gjeneralit Clark në librin e këtij të fundit “Të bësh luftë moderne”. Në libër ka shumë të dhëna për takime, biseda e shqetësime si me faktorët politik të Kosovës dhe Shqipërisë, ashtu dhe me drejtuesit ushtarakë. Thënë ndryshe në sitën e gjeneralit kanë kaluar militarët dhe pacifistët, të vendosurit dhe ikanakët, të ndershmit dhe të korruptuarit, të kamurit dhe të varfrit. Shumë nga këto ballafaqime vendosin përballë njëri-tjetrit eksponentë të politikës së djeshme dhe të sotme të Kosovës. Edhe pse në anë me luftëtarët gjenerali i kritikon ata në lidhje me gabimet që ata bënë kryesisht pas luftës, por këta janë disa individë siç i përmend ai, të cilët nuk e zhbëjnë dot imazhin pozitiv që ka Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Thirrja e Klintonit se; “Hezitimi

është leje për të vvarë”, i dha fund dilemës për të ndërhyrë në Kosovë. Duke ju referuar rolit të NATO-s, gjenerali na kujton që lufta çlirimtare ishte ajo e cila u bë shtysë për ndërhyrjen ushtarake nga ana e Aleancës më të fuqishme Botërore. Kjo e vërtetë solli dhe ndryshimet e mëdha në marrëdhëniet e Europës dhe të organizmave ndërkombëtare, me kombin shqiptar në tërësi dhe Kosovën në veçanti. Shtetet e Bashkuara të Amerikës evidentohen si faktori vendimtar për aktivizimin luftarak dhe suksesin e NATO-s në Kosovë. Amerikanët e çmojnë vlerën e jetës, e dinë mirë se çdo njeri ka të drejtë të jetë i lirë. Duke qenë si i tillë amerikan, presidenti Clinton e kishte kuptuar sakrificën sublime që kishin ndërmarrë djemtë dhe vajzat luftëtarë të Kosovës në emër të jetës në liri, ndaj nuk hezitoi. Në tekstet sumere me shkrimin kuneiform rrëfëhet një legjendë. Adapu (modelit të njeriut) iu dha mundësia të bëhej i pavdekshëm, thjesht të shijonte “Bukën e Jetës”. Ndërsa ai e refuzoi atë, e u kthye në tokë si prifti pagan me diturinë më të madhe për të rrëfyer. Njëtrajtshëm në mitin biblik Adapu ngjason me Noen, por po në këtë mitologji hiqen paralele të (modelit të njeriut) dhe Adamit të Biblës”. Kështu pra si një njeri me frymëzim të hyjnishtëm, nëpërmjet këtij libri Kudusi Lama ka treguar se di të bëjë saktësisht analiza shumë-pamjesh, ka treguar që është një idealist dhe nationalist, ka treguar se e vërteta dhe mendimi kritik kanë vlera të jashtëzakonshme. Të gjithë përbërësit e kësaj sipërmarrje kanë frymë aktuale, kanë originalitet, kanë humanizëm, ndërsa autori ka aftësinë për t’i dhënë në dorë lexuesit një të tillë libër me vlera ku historia rroket nga një frymë e tillë e fuqishme.





## Rasmussen zhvillon bisedime në Londër rreth samitit të Uellsit



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, diskutoi në Uells rreth përgatitjeve për samitin e NATO-s, i cili do të zhvillohet në muajin shtator dhe falënderoi Mbretërinë e Bashkuar, e cila do të presë këtë samit, gjatë bisedimeve me kryeministrin David Cameron më 3 shkurt. “Ky samit do të formësojë të ardhmen e Aleancës sonë. Ne do të sigurohemi që NATO të ketë pajisjet dhe aftësitë e përshtatshme që janë të nevojshme për t’u përballur me kërcënimet, të tilla si terrorizmi, shtetet e paqëndrueshme, pirateria, sulmet raketore e kibernetike”, tha Sekretari i Përgjithshëm.

Rasmussen shprehu mirënjohjen e tij për kryeministrin dhe zyrtarë të tjerë të lartë që u ofruan për të pritur këtë samit, i

cili sipas tij reflekton rolin udhëheqës që Anglia luan në zemër të NATO-s. “Kjo tregon angazhimin tuaj në bashkëpunimin transatlantik dhe sigurinë ndërkombëtare”, tha ai. Gjithashtu, Rasmussen falënderoi forcat britanike për përpjekjet e tyre në Afganistan. “Falë ISAF-it, kombet tona janë më të sigurt dhe Afganistani është më i fortë, ndërkohë që merr përgjegjësinë për të ardhmen e vet”.

Po ashtu gjatë vizitës së tij në Londër, Sekretari i Përgjithshëm pati takime me ministrin e Jashtëm, William Hague, ministrin e Mbrojtjes, Philip Hammond, sekretarin e Shtetit të Uellsit, David Jones si dhe me anëtarë të Komitetit të Përzgjedhur të Mbrojtjes në Parlamentin Britanik.

## Fjala e sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s në Konferencën e 50 të Sigurisë së Mynihut

# NATO dhe Rusia – Koha për t’u angazhuar

**J**u falënderoj për mundësinë për të shqyrtuar një çështje e cila është kryesore për Europën dhe sigurinë euroatlantike: Marrëdhënia ndërmjet NATO-s dhe Rusisë. Kjo ishte tema e fjalimit tim të parë si sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, në vitin 2009. Jam i sigurt për atë çka mbetet e vërtetë sot: Ndër të gjitha marrëdhëniet e partnerëve të NATO-s, asnjë nuk ka potencial më të madh se sa ajo ndërmjet NATO-s dhe Rusisë, por sot ai potencial nuk po përmbushet plotësisht. Ne përballemi me një zgjedhje të qartë. Ndërmjet pranimit dhe bashkëpunimit, ose synojmë për angazhim konstruktiv dhe ecim përpara drejt partneriteteve strategjike, të cilët ofrojnë sigurinë e përbashkët që ne kërkojmë.

Fakti është se ne sot po bëjmë së bashku më shumë se kurrë më parë. Rusia mbështet me transit operacionin tonë në Afganistan. Së bashku ne trajnojmë zyrtarë në rajon për të ndaluar që droga të kalojë kufijtë tanë. Ne po zhvillojmë teknologji për të ndaluar terroristët që të mbajnë bomba në metro ose të rrëmbejnë avionë. Ne po heqim armët e vjetra dhe të rrezikshme nga toka dhe përdorimi në Kaliningrad. Ne kemi rënë dakord për mbështetjen e përpjekjeve për të hequr armët kimike nga Siria. Tani po eksplorojmë se si mund të ndihmojmë në aspektin praktik në kuadër të Këshillit NATO-Rusi. Unë kam besim që Rusia do të bëjë çmos të nxisë qeverinë siriane për të përmbushur angazhimin e saj dhe në përgjithësi në marrëdhëniet tona, duhet të jemi më ambiciozë, duhet të jemi më të guximshëm në adresimin e sfidave tona, sepse kemi interesa themelore.

Ne ndajmë nevojën për stabilitet në vendin tonë dhe në të gjithë zonën euroatlantike: Nevojën për të frenuar terrorizmin, ekstremizmin dhe përhapjen në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut, e cila na kërcënon të gjithë ne si dhe nevojën për të thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe tregtinë mes popujve tanë në një botë të globalizuar.

Unë jam i bindur se vizioni për të cilin ramë dakord në Lisbonë 2010 mbetet i duhuri: Një partneritet strategjik i vërtetë ndërmjet NATO-s dhe Rusisë, por jam i shqetësuar se në fushat kryesore, ne mbetemi shumë larg njëri-tjetrit. Unë shqetësohem kur dëgjoj të flitet për vendosje ofensive, jo mbrojtëse, por ofensive, të sistemeve të armëve, të tilla si detashmente luftarake



në Bjellorusi, raketa Iskander në Kaliningrad ose më shumë forca ushtarake në Arktik. Shqetësohem kur dëgjoj se sistemi ynë i mbrojtjes raketore përshkruhet vazhdimisht, në mënyrë të gabuar dhe false nga ana e Rusisë si ofensiv dhe shqetësohem gjithashtu kur dëgjoj se Rusia e sheh politikën e dyerve të hapura të NATO-s si një kërcënim, si terrorizmi ndërkombëtar.

Asnjë prej nesh nuk do një rikthim në vijat ndarëse dhe armiqtësinë e së kaluarës. Pra, le të mos përdorim fjalët e mënyrat e së kaluarës dhe le të ecim përpara. Në Lisbonë, NATO dhe Rusia ranë dakord të kontribuojnë në zhvillimin e një hapësire të përbashkët

paqeje, sigurie dhe stabilitet në zonën euroatlantike. Kjo nuk do të thotë traktate të reja, por t’i qëndrosh besnik parimeve duke marrë hapa konkretë.

Së pari, duhet t’i frenojmë kërcënimet kundër njëri-tjetrit. Kjo është ajo për të cilën ramë dakord në Aktin Themelues NATO-Rusi të vitit 1997. Kjo është arsyeja pse vendosja e armëve të reja sulmuese nuk ka vend në një partneritet të vërtetë strategjik. Në vend të kësaj, duhet të ndërtojmë besim dhe transparencë, siç u përcaktua në Deklaratën e Romës të vitit 2002. Së dyti, duhet të përputhem me parimet e Kartës së OSBE-së 1999 për Sigurimin European. Kjo riafirmoi të drejtën e

natyrshme të çdo shteti për të qenë i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë marrëveshjet e tij të sigurisë dhe aleancat. Ukraina duhet të ketë lirinë të zgjedhë rrugën e vet, pa presion të jashtëm. Parimet demokratike dhe sundimi i ligjit duhet të zbatohen si dhe pakicat duhet të mbrohen e jo të persekutohen. Së treti, duhet të arrijmë një marrëveshje për bashkëpunimin e mbrojtjes raketore. Kemi dëgjuar shqetësimet e Rusisë se sistemi i NATO-s do të minojë strategjinë e saj bërthamore, por kjo injoron faktet dhe ligjet e fizikës. NATO ka ofruar të krijojë lidhje ndërmjet dy sistemeve të mbrojtjes raketore. Kjo do të bëjë që ekspertët tanë të punojnë së bashku në

një bazë 24 orë në 24. Kjo do të ndërtojë besim dhe transparencë dhe do të përmirësojë mbrojtjen për të gjithë ne, në Rusi dhe në Europë. Deri më tani, Rusia e ka hedhur poshtë propozimin e NATO-s. Nëse duam të ecim përpara, nuk kemi kohë për të humbur. Tani nuk është koha për justifikime, por është koha për t’u angazhuar. Pra, duhet të vendosim një afat të arsyeshëm e të gjejmë një marrëveshje pragmatike se si të ecim para.

Së katërti, duhet të marrim përsëri kontrollin e armëve. Duhet të bëjmë progres në zvogëlimin e armëve bërthamore sub-strategjike. Në NATO jemi të përgatitur të flasim për transparencën e këtyre armëve dhe i bëj thirrje Rusisë të angazhohet në bisedime me ne, por ajo duhet të jetë e gatshme të diskutojë këto çështje pa parakushte. Kërkesa ruse që NATO të heqë të gjitha armët bërthamore në Europë, para se të fillonim negociatat, nuk do të shpjerë askund. Gjithashtu, duhet të diskutojmë lidhur me armët konvencionale. Rusia ka thënë se nuk do t’i kthehet kurrë Forcave Konvencionale në Traktatin e Europës, por duhet të diskutojmë si të ri-ndërtojmë një regjim që na bën të gjithëve më të sigurt. Ne duhet t’i rikthehem stërvitjeve ushtarake të ndërsjella e reciproke. Duhet të jemi më transparent me njëri-tjetrin për të gjitha stërvitjet tona ushtarake dhe aktivitetet në mënyrë që të rrisim besimin. Asnjë nga këto nuk do të ndodhë brenda natës, por me vullnetin politik ne mund të shmangim rrezikun e bashkëpunimit të ftohtë. Ne mund të lëvizim përpara drejt angazhimit konstruktiv dhe partneritetit të vërtetë strategjik që kemi rënë dakord të arrijmë”.

## NATO kryen fluturime me vendet partnere për herë të parë në Islandë

Avionë luftarakë të NATO-s dhe vendeve partnere nisën të kryenin më 3 shkurt, një gamë të gjerë aktivitetesh që lidhen me fluturime të mbrojtjes ajrore islandeze, rasti i parë i këtij lloji që u krye në ishull. Takimi Ajror i Islandës 2014 (IAM2014) mblodhi së bashku pjesëmarrës nga anëtarët e NATO-s, Islandën, Norvegjinë, Holandën dhe Shtetet e Bashkuara si dhe nga vendet partnere, Finlandën dhe Suedinë, të mbështetura nga AWACS të NATO-s.

“Ky është një hap më përpara në bashkëpunimin e shkëlqyer të NATO-s me Finlandën dhe Suedinë: Hera e parë që kemi fluturuar së bashku në Islandë”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen. Aftësia për të vepruar me vendet përtej Aleancës është një nga aftësitë

bazë të NATO-s. Veprimtaria e trajnimit, e cila vjen në kuadër të Bashkëpunimit Nordik të Mbrojtjes (NORDEFKO), e përforcon këtë aftësi. Aktivitetet e mbuluara nga IAM2014 do të përfshijnë trajnime luftarake ajrore midis llojeve të avionëve të ndryshëm, operacione kundërajrore si dhe sulme e mbrojtje me vlerë të lartë. “Falë këtij trajnimit, pilotët tanë, ekipet në terren dhe kontrollorët luftarakë do të trajnohen më mirë, do të kenë më përvojë dhe do të jenë më të aftë të vendosin e të veprojnë së bashku, nëse nevojitet”, tha Rasmussen.

Norvegjia, Finlanda dhe Suedia dërguan avionë luftarakë dhe avionë mbështetës në këtë ngjarje. Shtetet e Bashkuara dhe Holanda po sigurojnë vlera furnizuese nëpërmjet ajrit, ndërsa Islanda po ofron

mbështetje si vend pritës, duke përfshirë aftësitë e kërkimit dhe shpëtimit. NATO koordinoi veprimtarinë nëpërmjet Qendrës së Operacioneve Ajrore të Kombinuara (CAOC), në Uedem, Gjermani. Norvegjia siguroi drejtorin e trajnimit për këtë ngjarje. Avionët finlandezë dhe suedezë janë nën kontrollin e tij operacional. IAM2014 merr përparësi nga vendosja bashkëvepruese e Norvegjisë në Islandë në kryerjen e misionit të NATO-s për të siguruar aftësi të mbikëqyrjes dhe përgjimit ajror për të plotësuar në këtë mënyrë nevojat e gatishmërisë së Islandës në kohë paqeje. Megjithatë, IAM2014 është i ndarë dhe dallon nga ky mision, i cili është kryer vetëm nga aleatët e NATO-s.



# Hapen kurset e para për vitin 2014 në ANO

*Zëvendëskomandanti i Akademisë së Nënoficerëve flet mbi procesin mësimor*

Nga: Nënkolonel  
Muhamed GUZA

**B**azuar në Planin e Arsimimit 2014 të miratuar nga SHSHP të FA dhe Urdhrit e Komandantit të KDS-së për fillimin e kurseve institucionale dhe funksionale për vitin 2014, ANO mbylli me sukses këtë javë procesin e regjistrimit, testimit, pranimit e më pas fillimit të kurseve të para për vitin 2014 në Akademinë e Nënoficerëve "Thomson". Më datë 20.01.2014 filloi procesin mësimor Kursi i 30-të Bazë i Nënoficerit (KBN) dhe më datë 03.02.2014 filluan Kursi i 51-të Fillestar i Nënoficerit (KFN) dhe Kursi i 31-të i Avancuar i Nënoficerit (KAN). Për të ardhur deri këtu është dashur të ndërthuren mjaft mirë me njëri-tjetrin disa elementë të cilët kanë bërë të mundur zhvillimin e një procesi të tërë para fillimit të kurseve, proces i cili është i ndarë në disa faza dhe zgjat dy javë për secilin kurs.

Bazuar në Planin e Arsimimit 2014 të miratuar nga SHSHP të FA si dhe kriteret përkatëse për pranim në secilin kurs të përcaktuara në Manualin e Personelit dhe Rregulloren e Brendshme të ANO-së u zhvillua regjistrimi i të gjithë kandidatëve të dërguar nga njësitë dhe repartet ku ata bëjnë pjesë, për të qenë më pas pjesë e procesit të testimit të kandidatëve që i plotësojnë kriteret për tu pranuar në kurset respektive. Pas regjistrimit të të gjithë kandidatëve për secilin kurs është bërë përzgjedhja e tyre nga komisionet përkatëse të ngritura në ANO për përzgjedhjen e kandidatëve në bazë të kriterëve të plotësuar, si moshë, koha e qëndrimit në gradë, gjuha e huaj etj. Pas përfundimit të kësaj faze është bërë njoftimi i të gjitha njësiteve e reparteve që kanë dërguar kandidaturë për kandidatët që i plotësonin kriteret. Me përfundimin në kohë dhe brenda standarteve të kërkuara, ky proces i kryesuar nga Dega e Arsimimit, kalon në fazën e tij më të rëndësishme, atë të testimit të kandidatëve.

Për të qenë pjesë e kurseve në Akademinë e Nënoficerëve është e domosdoshme të plotësohen disa kriterë, ku më kryesorët janë kondicioni fizik dhe ai intelektual. Për këtë arsye edhe këtë herë ANO, si në çdo rast të fillimit të kurseve të reja, u zhvilluan dy teste hyrëse për secilin nga kurset me vete. Kështu u zhvilluan në dy ditë të ndryshme Testi Fizik dhe ai Intelektual. Me përfundimin e testeve procesi kaloi në fazën e fundit të tij, atë të përzgjedhjes së kandidatëve fitues për vazhdimin e kursit respektiv në bazë të rezultateve të testeve hyrëse nëpërmjet një komisioni të posaçëm të ngritur me Urdhër të Komandantit të ANO-së.

Me përfundimin e këtij procesi mjaft të rëndësishëm kandidatët e



përzgjedhur fillojnë procesin mësimor pranë Akademisë së Nënoficerëve. Aktualisht, me fillimin e tre kurseve të para për vitin 2014, në ANO filluan arsimimin 45 kursantë në KBN, i cili do të zgjasë deri në 11.04.2014, 43 kursantë në KFN, deri në 07.03.2014 dhe 19 kursantë në KAN, deri në 14.03.2014.

Gjatë kësaj periudhe këta kursantë do të marrin njohuri dhe aftësohen në rolin e drejtuesit sipas kurseve të grupit, skuadrës dhe zv/kom të togës. Ata do të arsimohen në trajnime elementare të përgjithshme të formimit të ushtarakut, dhe jo për specialitetet e ndryshme që ata mund të kenë. E rëndësishme është se në programet që do të zhvillohen në këto kurse gjen zbatim në praktike linja e komandimit sipas kurseve

Përsa i përket programeve të arsimimit, kurrikulave, që përdoren në kurse duhet theksuar se është kryer një proces i ripunimit të tyre, i cili vazhdon të zhvillohet në mënyrë të

vazhdueshme duke u bazuar në dy elemente kryesorë. Së pari në përputhjen e këtyre kurrikulave me nevojat që ka FA, pra duke u mbështetur në misionin dhe angazhimet e FA si brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë që nënoficerët të marrin ato njohuri që ju nevojiten dhe të jenë sa më produktivë për përmbushjen e këtyre detyrave apo misioneve që FA kërkojnë. Dhe së dyti në plotësimin e standarteve të NATO-s, duke qenë se tashmë kemi një vend anëtar i aleancës detyrat dhe angazhimet tona kanë ndryshuar, por po kështu kërkohet që të jenë në përputhje me to dhe standartet, kriteret dhe të gjithë elementët që përbëjnë formimin e një nënoficeri të aftë për përballimin e situatave dhe përmbushjen me sukses të detyrave të caktuara në krah me partnerët e vendeve aleate.

Një element tjetër mjaft i rëndësishëm për procesin e arsimimit, dhe konkretisht për atë të ripunimit të vazhdueshëm të programeve mësimore,

janë edhe Mësimet e Nxjerra. Kështu në ANO në përfundim të çdo kursi zhvillohet një Anketim anonim me të gjithë kursantët, të cilët janë përgatitur në bashkëpunim dhe me disa instruktorë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it. Qëllimi i këtyre anketimeve është përmirësimi i metodave të mësimdhënies si dhe rritja e performancës dhe rezultateve pozitive të kursantëve.

Por a mund të mendohet një arsimim efektiv pa instruktorë të përgatitur dhe të gatshëm për të ndihmuar kursantët në rritjen e njohurive të tyre? Patjetër që jo. Instruktorët apo mësimdhënësit janë hallka më e rëndësishme e të gjithë këtij procesi arsimimi e trajnimit. Janë ata që duhet të japin shembullin të parët, janë ata që duhet të tregojnë seriozitetin dhe përkushtimin në atë çka bëjnë, janë ata që duhet të tregojnë se "Grada është simbol i përgjegjësisë...", janë ata që duhet të tregojnë se "Kurajë morale është shumë më shumë e domosdoshme se kurajë fizike". Vetëm kontributi i spikatur i nënoficerëve dhe instruktorëve të aftë

për stërvitjen dhe operacionalitetin do të krijojë themelin për rolin e ri dhe funksionimin e hallkës - nënoficer. Vetëm kontributi dhe domosdoshmëria e mbi të gjitha bërja e dukshme që roli i tyre ka lehtësuar punën e oficerëve dhe ka përmirësuar standartet e stërvitjes dhe operacionalitetin për nivelin që u takon është kyçi që do të hapë rrugën e marrjes së përgjegjësisë nga nënoficerët. Ndaj një nga prioritetet e ANO-së është trajnimi dhe zhvillimi i vet instruktorëve të saj. Këtu s'mund të lëmë pa përmendur punën dhe angazhimin që po tregojnë tre instruktorët të ANO-së në projektin - pilot "Black Eagle 001", në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të New Jersey-it, me kandidatët për Oficer në drejtim të përgatitjes fizike të tyre, instruktorë që fillimisht u trajnuan nga pala amerikane si instruktorë të përgatitjes fizike.

Komanduesit e të gjithë niveleve kërkojnë, fitojnë por edhe delegojnë autoritetin. Një nga përgjegjësitë e komandantit është edhe formimi dhe zhvillimi i liderëve të rinj. Jo vetëm njohuritë e marra në ANO, por edhe eksperiencia e fituar në njësitë apo repartet ku shërbejnë i bëjnë liderët e rinj komandantë të vërtetë. Nga pikëpamja sociale të gjithë njerëzit dëshirojnë të kenë sa më shumë pushtet por të mbajnë përgjegjësi për sa më pak detyrime. Nga ana tjetër sa më shumë përgjegjësi aq më i madh është prestigji dhe autoriteti i individit. Problemi në gjithë këtë qëndron në faktin se delegimi i autoritetit nuk është asnjëherë i dëshiruar. Nga ana tjetër t'i japësh autoritetin tënd një nënoficeri të ri do të thotë ta formosh dhe zhvillosh atë si drejtues. Jo vetëm delegimi por edhe ndihma për të rritur autoritetin e tyre duhet të jetë e pakursyer. Ndaj dhe ANO po punon shumë në këtë drejtim, duke e pasur si një ndër prioritetet e saj rritjen e përgjegjësisë të nënoficerit dhe futjen e tyre në procesin e vendimarrjes.





# Roli i shtypit për mobilizimin e popullit në luftën kundër pushtuesve

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj  
Historian ushtarak

## Shtypi gjatë LANÇ-it

*Shtypi gjatë LANÇ-it qëndron si një shembull i shkëlqyer i ndershmërisë së lartë ndaj çështjes së popullit e të Atdheut, i guximit të shprehjes së mendimit, i vendosmërisë për të mbrojtur e përhapur atë*

Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1945), Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri, e vlerësoi drejt rolin e shtypit për mobilizimin e popullit në luftën kundër pushtuesve nazifashistë. Agjitacioni i vogël gojor, parullat e shkruara herë pas here nëpër mure e sheshe publike si dhe ndonjë trakt, ishin krejtësisht të pamjaftueshme për të përballuar fushatën mashtruese të gjithë atij shtypi të përditshëm e periodik që organizoi fashizmi Italian sapo shkeli në vendin tonë. Në një trakt të parë masiv thuhet se Lufta Nacionalçlirimtare ka filluar dhe të gjithë shqiptarët e ndershëm, që duan me të vërtetë Shqipërinë, të bashkojnë të gjitha forcat për t'i vënë në shërbim të luftës për çlirim kombëtar. Thirrje e trakte kanë dalë në shkurt 1942 që u drejtohej ushtarakeve, në prill 1942 që i drejtohej punëtorëve, në korrik 1942 që i drejtohej fshatarësisë etj. Dalja në dritë e këtyre dokumenteve, në kushtet e një reksioni të egër dhe të ndjekjes e të persekutimit të çdo mendimi e ideje që i kundërvijeh pushtimit fashist dhe politikës së tij, ishte një sfidë e rëndë për propagandën e tij. Në mjaft trakte flitet për luftën dhe qëndrimin heroik të luftëtarëve. Këto trakte nuk përshkohen nga fryma e vajtimit, e përkuljes edhe kur humbja është e rëndë, po nga vendosmëria për qëndresë e hakmarrje si ë rastin e rënies së Qemal Stafës, të Misto Mames etj. Çlirimi me çdo kusht i Atdheut nuk është shtruar asnjëherë si diçka që do të vinte nga jashtë, por gjithmonë si rezultat i luftës së vendosur që do të bënte vetë populli ynë. Megjithatë, roli ndihmës i faktorit të jashtëm nuk është lënë pa u përmendur. Roli i Bashkimit Sovjetik dhe i peshës së Ushtrisë së Kuqe në luftën kundër armikut të përbashkët kanë zënë vendin e duhur në këto mjete të propagandës. Po kështu me vëmendje është propaganduar lufta e popujve fqinjë, grek, serb, bullgar etj. Thëniet e armikut mbi të ashtuquajturën “rrezik serb e grek”, janë hedhur poshtë me përbuzje, si synime të pushtuesve për të përçarë popujt e robëruar, që ata t'i sundonin më lehtë. Aleanca anglo-sovjeto-amerikane është trajtuar drejt, si një “aleancë popujsh”. Duke pasur këtë tipar karakteristik, me tonin e tyre luftarak, me parullat mobilizuese, me një gjuhë të thjeshtë dhe komunikuese, traktet kanë prekur ato probleme që ishin në shpirtin dhe në zemrën e popullit patriot siç ishin Atdheu, nderi, liria, pavarësia, familja, e ardhmja e tyre. Kështu traktet kanë luajtur rolin e një arme me qitje shpërthyes, që kanë goditur rëndë armikun dhe kanë shpartalluar planet e tij skllavëruese. Tipar karakteristik i trakteve ishte shpejtësia dhe operativiteti në kapjen e çështjeve. Botimi i tyre në shumë raste brenda ditës ose disa orëve, pas një ngjarjeje të ndodhur, e kanë çoroditur armikun dhe e kanë demaskuar atë para opinionit të masave. Tipik është trakti i shtypur në Tiranë në shtypshkronjën e armikut, që njofton goditjen me top të Asamblesë së Gestapos. Ai është një trakt vetëm me 14 rreshta, por që i thotë të gjitha. Përdorimi i këtyre mjeteve për agjitacion e propagandë, për t'u lidhur e për të komunikuar me masat, në kushtet e vështirë të luftës e të ilegalitetit të thellë të imponuar nga armiku, është një dëshmi e pjekurisë së atij brezi dhe të FNÇ. Në të njëjtën kohë përgatitja dhe shpërndarja e tyre tregon ven-



dosmërinë dhe guximin për ta përdorur këtë armë në kohën e duhur. Efekti i tyre në ngritjen e ndërgjegjes politike të masave ishte i jashtëzakonshëm. Roli i tyre për demaskimin e propagandës së armikut ishte dërmues. Shtypi u mbrojt me aspiratën dhe shqetësohet e popullit, luftoi për të, zbuloi shtigje dhe çeli rrugë me thonj e me dhëmbë, kur erdhi puna, për t'u dalë në krye detyrave dhe misionit të caktuar. Pikërisht pse ishte i tillë, ai fitoi që në fillim dashurinë dhe besimin e popullit dhe pati gjatë gjithë rrugës mbështetjen dhe ndihmën e tij pa rezervë. Pa përfillur vdekjen, qindra bij të popullit, anëtarë të njësiteve guerile, ndërmorën aksione nga më të guximshmet mbi zyra, depo e shtypshkronja të armikut, për të krijuar bazën materiale e teknike të shtypit. Qindra të tjerë vunë jetën në rrezik për të transportuar nga njëri vend në tjetrin përmes terrorit dhe rojeve armike, teknikën dhe materialet e saj. Qindra familje të popullit nuk kursyen jetë, shtëpi e katandi, në qytete e në fshatra për t'i shndërruar banesat e tyre në baza aktive të kësaj teknike. Shpërndarja dhe leximi në masë i shtypit ilegal ishte një aksion i përgjithshëm i popullit, që kryhej me kokë në torbë nën hundën e pushtuesit dhe të spiunëve të tij. Çfarë formash dhe mënyrash të mrekullueshme nuk krijoi mendja e popullit, guximi dhe besimi i tij në fitore e për të çuar deri në kasollen e izoluar

të vendit zërin e luftës. Çfarë taktike të zgjuar nuk përdori ai për të fshehur nga syri i armikut shtypin e kohës. Parulla luftarake, “lexoje, shpërndaje dhe mos ia dorëzo armikut”, që u bë motoja lëvizëse për shpërndarjen dhe përdorimin e të gjithë shtypit ilegal, e ka nismën e saj pikërisht edhe në vështirësitë dhe kushtet e vështira të luftës. Në këto kushte të vështira të luftës u bë e mundur të botohen në ilegalitet disa organe si: gazetata “Zëri i Popullit” e “Bashkimi”, revista “Kushtrimi i Lirisë” organ i rinisë antifashiste shqiptare, revista “Gruaja shqiptare”, revista letrare “Liri” etj. Redaksitë e këtyre organeve shpesh botonin dhe shpërndanin edhe trakte antifashiste, buletine e komunikata operative lufte. “Zëri i Popullit” pa dritën e botimit më 25 gusht 1942 në kushtet e një ilegalitetit të thellë. Ndërsa “Kushtrimi i lirisë” doli në fund të gushtit 1942, për t'u pasuar më tej nga “Bashkimi” që doli në mars 1943, si organ i Këshillave Nacionalçlirimtare. Gazeta mbron me forcë tezën se “Liria nuk dhurohet, por fitohet”. Revista “Gruaja shqiptare” doli në korrik 1943 dhe ishte pohim i pjesëmarrjes së gruas, i personalitetit të saj politik dhe shoqëror, si dhe i vendosmërisë së saj për të ecur krah për krah me të gjithë popullin në luftën e madhe për çlirimin kombëtar e shoqëror të vendit. Organe të tjera kanë qenë dhe

“Buletini” i LANÇ-it, i qarkut të Tiranës; i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-it; i Shtabit të Zonës së Parë Operative etj. Organe periodike kanë dalë në ish qarqe si: “Korça e re” në Korçë; “Liria” në Shkodër; “Përpjekja e rinisë”, “Trumbeta çlirimtare” dhe “Fshesa” në Vlorë; “Tribuna e rinisë” në Elbasan etj. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare ka nxjerrë një tërësi rregulloresh, instruksionesh e qarkoresh të cilat kanë ndihmuar në forcimin e rregullit e të disiplinës, të jetës së brendshme, të përgatitjes luftarake si dhe në rritjen e njohurive të shtabeve për organizimin dhe drejtimin e operacioneve. Por qarkoret, instruksionet e rregulloret i kanë shërbyer njëherazi edhe përpunimit të mendimit ushtarak, duke parashtruar një bazë teorike qoftë edhe të kufizuar që ndihmon gjithsesi për të vënë ushtrinë në baza të shëndosha instruktivo-metodike e për të siguruar rritjen e fuqizimin e saj si një ushtri e rregullt. Edhe pse në kushtet e ilegalitetit të thellë të luftës, shtypi i LANÇ-it, arriti të shpërndahet në fshatra e qytete, në çetat partizane, në formacionet e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare shqiptare, të lexohet me ende e të bëhet një ndër faktorët themelorë për zgjerimin e luftës në Shqipëri, për krijimin e një ushtrie të fuqishme e për arritjen e fitores; për bashkëpunimin me forcat aleate që

vepronin në Shqipëri etj. Brigadat Sulmuese kishin shtypin e tyre. “Përpara në sulm” ishte organi i Br. I S, ku në numrin e parë theksohej “...se në të do të gjejnë vuajtjet, pengesat, luftën, guximin, me një fjalë jetën e tyre të përditshme... ushqimin e tyre mendor, do të gjejnë sqarime politike, dhe eksperiencë ushtarake”.

“Zëri i partizanit” organ i Br. II S shkruan theksonte se “...në llogoret e luftës, në shi e në breshër, del nga pena e partizanëve, ...ku do të pasqyrohen mendimet, dëshirat dhe jeta e reparteve tonë”.

“Zëri i luftëtarit” organ i Br. IV S; “Bucitja” organ i Br. V S; “Flaka” organ i Br. VI S, “Pishtari” organ i Br. VIII S; “Flaka” organ i Br. XII S (ka të njëjtin titull si Br. VI S); “Pararoja” organ i Br. III S; “Zani i partizanëve” organ i Br. XVIII S; “Vllazërimi” organ i Br. XIX S etj. Ndërsa shumë brigade kanë praktikuar botimin e “gazetave të xhepit” si Br. VII S; Br. XV S; Br. XVII S; Br. XX S; Br. XXIII S; Br. XXV S etj. Shtabi i Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër kishte organin me titull “Luftëtari i lirisë” etj. Div. I S botoi organin “Ylli çlirimtar”; Div. II S organin politiko-ushtarak “Përpara”; Div. VI S që vepronte në tokat Jugosllave organin “Vllazërimi i popujve”. Në këto organe me karakter politik, social e kulturor trajtohej një problematikë e gjerë, por vëmendja përqendrohej kryesisht në problemet e luftës. Këto organe u bënë tribuna të fuqishme të propagandimit të luftës së armatosur si faktori themelor për të fituar lirinë. Theksin e vinin në kultivimin e idesë së bashkimit e të pjesëmarrjes masive të popullit në luftë, rritjes së ndërgjegjes së masave, evokimit të dashurisë për Atdheun, shumëllojshmërinë e formave të luftës, krijimin e formacioneve luftarake si dhe bazë ishte mbështetja në traditat luftarake të popullit shqiptar. Duke vënë në dukje heroizmin e grave e të vajzave të reja shqiptare, braktisjen prej tyre të zakoneve e paragjyqimeve; ato evidentonin rolin e grave si një forcë aktive e luftës. Lufta e popullit shqiptar trajtohet si pjesë e luftës së përbashkët në shkallë botërore duke e inkuadruar atë në koalicionin e madh antifashist me në krye Britania e Madhe, Bashkimi Sovjetik, SHBA e shumë vende të tjera, çka e rriste më tej optimizmin dhe besimin për fitore. Për përgatitjen e një shtypi të gjerë dhe të gjithanshëm, për të krijuar bindjet e nevojshme mbi domosdoshmërinë e luftës së armatosur kundër armikut, për të luftuar në mënyrë të organizuar dhe pandërprerje propagandën e tij, që zhvillohej me mjete të shumta, duhej patjetër një bazë materiale minimale dhe mjete teknike elementare më të domosdoshme. Aksionet e njësiteve guerile për sigurimin e mjeteve të nevojshme për teknikën as nuk u prenë, as nuk u pakësuan. Duke vazhduar aksionet në Tiranë u siguruan mjete që krijuan bazën e teknikës. Në Korçë në muajin mars 1943 teknika e komitetit qarkor kishte 7 ciklostilë, 12 makina daktilografike, qindra topa letër



*Në një trakt të parë masiv thuhet se LANÇ ka filluar dhe të gjithë shqiptarët e ndershëm, që duan me të vërtetë Shqipërinë, të bashkojnë të gjitha forcat për t'i vënë në shërbim të luftës për çlirim kombëtar.*



*Tipik është trakti i shtypur në Tiranë në shtypshkronjën e armikut, që njofton goditjen me top të Asamblesë së Gestapos. Ai është një trakt vetëm me 14 rreshta, por që i thotë të gjitha.*






dhe 50 kuti me letër dylli. Rezerva të tilla u krijuan edhe në qytete të tjera të vendit. Studentët shqiptarë, që studi-onin në Itali, kanë sjellë me të hollat e tyre, në qershor 1942 më shumë se katër rula ciklostili, letër dylli etj. Në shtypshkronjën "Gutenberg" më 2 gusht 1942 u mor një shtypshkronjë me të gjithë materialin e nevojshëm. Kjo shtypshkronjë u vendos në Pezë dhe më pas te Guri i Mizhaqit në malet e Martaneshit. Shtypshkronja u morën në Vlorë në shkurt 1943, në Korçë në qershor 1943 etj. Është e kuptueshme se përdorimi pandërprerje i këtyre mjeteve ishte i vështirë, sepse në qytete ato gjurmoheshin nga armiku dhe në zonat e lira organizoheshin vazhdimisht operacione ushtarake, që bënin të ndër-pritej puna, e në mjaft raste këto mjete tërhiqeshin për t'u fshehur në vende më të sigurta. Mjetet e punës vendoseshin në dhoma të maskuara mirë, kryesisht nëpër bodrume. Në raste të ndryshme janë hapur edhe gropa të padukshme nën dhe, në të cilat mund të hyje vetëm

nga gryka e positi. Një gropë e tillë është përdorur në Tiranë. Në Vlorë, në bazën ku ishte vendosur teknika, dera e hyrjes ishte transformuar në një qymez pulash, kurse në Gurin e Muzhaqit, ndënë grykën e hyrjes së shkëmbit, ishte hapur një gropë për vendosjen e shtypshkronjës. Këtu hyej nëpërmjet një shkalle të maskuar. Në të gjitha qytetet e tjera janë përdorur mënyra të ndryshme maskimi. Kujdes tregohet për fshehjen e materialeve me të cilat punohej. Për këtë janë përdorur hapësirat ndërmjet mureve, boshllëku midis kanatave të dyerve e vendeve të tjera të fshehta. Vëmendje e veçantë tregohet kur punohej, që zhurma të mos dëgjohej jashtë. Makinat daktilografe vendoseshin mbi jorganë ose batanije. Drita maskohej mirë për të mos u dukur jashtë. Ishin marrë masat e nevojshme që shërbimi i shtypit të mos ndërpritej në rast se ndonjë bazë zbulohej nga armiku. Për këtë ishin krijuar baza rezervë. Vlen të theksojmë se bazat ilegale të teknikës në zonat e çliruara kanë pasur vigjilencë

të veçantë nga komandat e reparteve partizane, që njoftonin me kohë për operacionin e armikut. Kujdesi i popullit për këto baza ka qenë i madh. Pjesëtarët e familjeve në shtëpitë ose kasollet ku vendosej teknika e shtypit nuk dinin konkretisht se ç'punë bëhej aty. Puna e shtypit ishte shumë konspirative. Një problem jo pak i rëndësishëm ka qenë përgatitja e shkrimeve të shtypit ilegal dhe niveli i tyre propagandistik. Për këtë problem nga fronti i përlëshjeve me armikun u grumbulluan rreth shtypit shkrimtarë, intelektualë të ndershëm e patriotë, që e donin Atdheun. Kështu edhe gjatë kushteve të vështira të sundimit e terrorit fashist, me qindra ish-in artikujt publicistik e shkrimet letrare, të nënshkruara me pseudonime të ndryshme. Problem i rëndësishëm mbetet shpërndarja e shtypit. Pa e organizuar dhe zgjidhur si duhej këtë problem, botimi i shtypit mbetet një qëllim në vetvete. Por shpërndarja e tij nuk ishte më pak e rrezikshme nga përgatitja dhe botimi i shtypit. Armiku ndiqte e persekutonte si ata që e përgatisnin ashtu dhe ata që e shpërndanin dhe e lexonin.

Shtypi i luftës sjell tiparet themelore të kësaj epoke. Ai luajti një rol të rëndësishëm në plotësimin e detyrave për mobilizimin e popullit për luftë. Kryerja e këtij misioni nuk ishte e lehtë, po të kemi parasysh kushtet në të cilat lindi dhe zhvilloi veprimtarinë e tij, që ishin aq të vështira, si për punën dhe ekzistencën e tij, ashtu edhe për objektivat që duheshin arritur. Ky shtyp, jo vetëm jetoi e u zhvillua në një shkallë të lartë, por arriti të bëhet një armë e pazëvendësueshme e shok i pandarë i mbarë popullit në luftën e tij të shenjtë për çlirimin e Atdheut, për një të ardhme të sigurt për popullin. Arritja e këtyre objektivave nuk është aspak një fenomen i rastit, por përkundrazi, rezultat i një sërë faktorësh të rëndësishëm që i dhanë mundësi këtij shtypi të vepronte, të komunikojë me masat e të lidhet gjithnjë e më shumë me to. Shtypi i luftës e kreu këtë detyrë, hap pas hapi, gjithnjë e më mirë e me forma nga më të kuptueshmet. Ky shtyp i shpjegoi popullit se lufta ishte e vetmja alternativë për çlirimin e Atdheut. Në artikujt e komente e shtypit të luftës, është bërë e kuptueshme cilat ishin forcat lëvizëse, me ç'rrugë e mjete duhej të bëhej mobilizimi i përgjithshëm politik, organizativ e ushtarak i popullit, cilët ishin aleatët e tij në këtë luftë, ç'rol do të luante faktori i jashtëm në raport



me atë të brendshëm etj. Theksojmë se propaganda armike nuk ka qenë e dobët as në sasinë e mjeteve të saj, as në argumentet që përdorte për të mashtruar popullin e për ta tërhequr atë në vathën e tij. Pushtuesit fashistë italianë botonin më se 40 organe shtypi, përveç mjeteve të tjera të agjitacionit e të propagandës siç ishin radioja, filmi, aktivitetet artistiko-kulturore, organizatat fashiste etj. Kur propaganda e tij u demaskua e populli i ktheu krahët, ai filloi të propagandojë "kotësinë" e luftës e dëmet e saj, sepse Italia fashiste do të merrte masa të rënda shtypëse e Shqipëria do të shkatërrohej. Kur lufta e armatosur e popullit shqiptar mori zhvillimin e saj të plotë dhe pushtuesi fashist po pësonte goditje të rënda, propaganda e tij lëshoi parullat e "rrezikut bolshevik" e atij "serb e grek" etj., duke u përpjekur të krijonte dyshime mbi LANÇ-in e objektivat e saj. Pushtuesi nazist gjerman po ashtu nuk mbeti prapa nga pushtuesi i mëparshëm në përdorimin e mjeteve të propagandës. Komanda e forcave ushtarake gjermane në organin "Liria e Shqipërisë" prej 10.000 kopje theksonte se "Gjermania naziste, s'kishte ardhur për të pushtuar vendin por për ta mbrojtur", dhe se "Shqipëria, sipas tyre, ishte çliruar". Kjo tezë u bë copë e thërrime nëpërmjet propagandës së LANÇ-it dhe luftës së armatosur kundër tyre. Armiku nëpërmjet shtypit të tij përçmonte virtytet më të larta të popullit tonë, kurse shtypi i luftës ngrinte lartë patriotizmin, besnikërinë, vendosmërinë, dashurinë për njeri-tjetrin, ndershmërinë etj. Shtypi i armikut popullarizonte terrori, masakrat dhe kërcënonte me masa të tjera shtypëse, kurse në faqet e shtypit

Gazetat më të thjeshta që quheshin gazeta xhepi, botoheshin peri-odikisht nga njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Në to analizoheshin kryerja e detyrave luftarake, përgjithësohej përvoja pozitive, kritikoheshin mangësitë, evidentohej mjeshhtëria luftarake dhe aftësitë drejtuese të luftëtarëve e kuadrove, si dhe shpalosej trimëria dhe heroizmi partizan e sidomos i dëshmorëve të njësisë.



## Shërbimi Ajror Special britanik (SAS)

Historia e grupit më të mirë botë  
për operacionet speciale

Përgatiti: Kapiten Ervin Hodo

**S**hërbimi Ajror Special Britanik (SAS), është ndoshta grupi i operacioneve speciale më i mirë që ekziston sot për sot. Kështu që nuk duhet të çuditemi që skuadra e Projekteve Speciale e SAS, është ndoshta grupi më i mirë kundërterrorist i njohur në botë. Njësia e PS normalisht përbëhet nga një personel prej afërsisht 80 trupash, të cilët janë të ndarë në 4 toga me nga 16-20 veta. Dhe ndërkohë që PS, vepron njëloj me kompanitë e tjera gjatë stërvitjes, pamja ndryshon komplet kur ndodh ndonjë incident me përmbajtje terrori. Në këto moment, një pjesë e togës ndahet duke krijuar grupin e vëzhgimit/snajperëve, ndërsa pjesa e ngelur e ushtarëve, formojnë atë që njihet si grupi i sulmit. Le të sqarojmë diçka këtu. Kompania e PS nuk është një "trup" i përhershëm. Në fakt të gjitha kompanitë SAS, kalojnë nëpër detyra kundërterrorizmit, nëpërmjet seksionit të Luftës Kundër Revolucionare. (Grupet e PS zakonisht keqidentifikohen si kompani të LKR). Këto cikle stërvitje për detyra të LKR, zakonisht zgjasin 6 muaj. Duke kontribuar në përmirësimin e aftësive të SAS, është edhe njësia "Operacioni i Kërkimeve për Njësinë", e cila zhvillon pajisje të veçanta për përdorim, nga skuadrat e Projekteve Speciale. Është kjo njësia, e cila krijoi granatën shokuese ("flash-bang"). Pajisjet e tjera përfshijnë, pajisje speciale për ngjitje në godina, dylbi të shikimit natën, pajisje audio/video etj. Ndryshe nga shumë grupe të operacioneve speciale, SAS-i e qarkullon gjithë kompaninë për kryerjen e detyrave për LKR. Për këtë arsye të gjithë operatorët e SAS-it konsiderohen kundërterroristë të kualifikuar dhe trajnimi rifikues është i vazhdueshëm për ta. Njësia e Projekteve Speciale, organizohet duke u ndarë në dy skuadra: Të Kuqë dhe Blutë, të përbërë nga 65 veta. Në çdo skuadër ka snajper dhe ekspertë të EOD. Aftësitë e SAS për përdorimin e armëve të zjarrit, janë shumë të larta, ato vazhdojnë të përsosin më tej gjatë ushtrimeve në qendra të banuara, dhe në luftimin e afërt në atë që njihet si "Killing House". Kursi bazë është gjashtë javë, gjatë së cilit togat mund të qëllonjë mbi 2000 fishekë. Kjo aftësi forcohet më tepër gjatë detyrave të PS që kryen kompania. Trajnimit i shtohet një moment realiteti duke përdorur personel real në rolin e pengjeve, gjatë ushtrimeve për pastrimin e dhomave. Trajnimi i SAS në luftën kundërterrorizmin dhe çlirimit të pengjeve, mbështetet nga anëtarët më të lartë të qeverisë Britanike, shumica e të cilëve (duke përfshirë edhe Kryeministrin) marrin pjesë në ushtrimet aktuale të stërvitjes së SAS. Një avion C-130 i Forcës Ajrore Mbretërore, qëndron në gatishmëri në çdo kohë që mund t'i nevojitet SAS. SAS-i, është angazhuar në operacione kundër terrorizmit, veçanërisht në Irlandën e Veriut,



megjithatë raportet flasin gjithashtu për angazhim të SAS në aktivitete në Libi. Ka një numër organizatash nëpër botë, që përdorin gjithashtu emrin SAS si p.sh SAS-i Zelandës së Re, dhe SAS-i i Australisë. Në Britani, shpesh zhvillohen debate në lidhje me atë se kur do të përdoret grupi tjetër legjendar britanik Special Boat Service (SBS) në luftën kundër terrorizmit. Kjo çështje është ende çështje spekulimi, megjithatë disa ekspertë spekulojnë se SBS, nuk ka për tu përdorur deri në momentin që do të ndodhë ndonjë incident terrorist i një shkalle shumë të madhe, çka do të ishte e pamundur të përballohej nga numri i personelit të SAS-it. SAS dhe SBS, njihen të jenë angazhuar së bashku në një alarm për bombë në tragetin Mbretëresha Elisabetë II. Megjithatë operacionet detare nuk janë një aftësi në të cilën SAS-i ngelet mbrapa. Çdo kompani ka gomonet e tij për togat, dhe ata janë shumë të përkushtuar ndaj kësaj pjese të stërvitjes. Ekziston një shkallë e lartë respekti dhe bashkëpunimi ndërmjet të dyja grupeve, përveç faktit që kur vjen fjala për vëmendje, SAS nuk pranon ta ndajë pjesën e luanit. Për të gjitha këto arsye që përmendëm më lartë, SAS ngelet shërbimi më i kërkuar nga partnerët për shkëmbim eksperience dhe për trajnim në luftën kundërterrorizmit. Trupat e SAS, kanë trajnuar trupa të grupeve të tjera speciale në botë si: Delta Forcë të SHBA, Skuadrën e Shpëtimit të Pengjeve të FBI-së, GIGN francez, GSG-9 gjerman, GEO spanjoll, Marinën Mbretërore Holandeze, grupet e SAS të Zelandës së Re dhe të Australisë. Këto janë vetëm disa dhe më kryesorët e grupeve speciale nëpër botë të trajnuar nga SAS. Në

shkëmbim të kësaj, këto grupe kanë lejuar SAS britanik të marrë pjesë në stërvitjet e trupave të tyre, në kuadër të shkëmbimit reciprok të informacionit. Ky program shkëmbimi, pati efektin e rritjes së aftësive kundërterroriste nëpër botë, në nivele akoma më të larta. Megjithatë SAS, kanë një nivel shumë të lartë përgatitje, ata përsëri janë të parët që thonë se aftësitë e tyre mund të përmirësohen akoma më tepër, dhe si rezultat ata janë gjithmonë në kërkim të rrugëve më të mira, për ta arritur këtë synim. Gjithashtu, është e dokumentuar se të paktën një në dy veta nga personeli i SAS-it, ka qenë i pranishëm në çdo operacion kundërterrorist, të përmasave të mëdha. Prezenca e tyre, shpesh ka qenë në rolin e një këshilltari zyrtar, por ish-anëtarë të SAS, kanë zbuluar se grupi ka dërguar shpesh njerëz në skenën e ngjarjes, thjesht për të mësuar sa më shumë të jetë e mundur, në lidhje me suksesin apo dështimin e operacionit. Ky informacion, më pas kthehet në Hereford, ku studiohet dhe aplikohet në mënyrë të drejtë. Duke folur mbi këtë, është interesante të nënvizojmë zhurmat që ekzistojnë në lidhje me mosbesimin e thellë të izraelitëve, një tjetër force speciale, nga më të mirat në botë. Për shkak të kësaj, SAS refuzuan për një periudhë kohe të angazhoheshin në ndonjë program shkëmbimi eksperience. Megjithatë, kjo ka kaluar dhe midis dy njësive ekzistojnë marrëdhënie shumë të mira, edhe pse nuk janë shumë të dukshme. Jo shumë kohë më parë, të paktën gjashtë anëtarë të SAS, dy oficerë dhe katër nënoficerë u dërguan në Lima, Peru në Dhjetor 1996 për të siguruar ndihmë dhe këshilluar qeverinë Peruane përpara se të vinte

incidenti i Prillit të 1997, ku rezultoi se u shpëtuan 71 nga 72 personat e marrë peng.

## Historia e Jeep-it të SAS

SAS (Special Air Service) britanik, u themelua nga kapiteni David Stirling dhe është një nga forcat speciale më elitë në botë. Motoja e famshme e Regjimentit është "Kush guxon fiton" ("W ho Dares W ins"). Historia e tij daton në Luftën e Dytë Botërore. Ideja e krijimit të një force vepruese në shkretëtirë, për të dobësuar linjat e furnizimit të Romelit dhe për të çorientuar operacionet ajrore, qëndronte në kokën e kapitenit David Stirling, ndërsa rikuperohej në spital, nga një aksident i pësuar gjatë trajnimit për hedhje me parashutë. Stirling, tashmë kishte fituar eksperiencë, për të punuar në prapavijë të armikut, në Afrikën e Veriut me Kolonelin Robert Laycock's, "Layforce" e Brigadës Komando. Megjithatë, për shkak të tre operacioneve të njëpasnjëshme fatkeqe, gjatë së cilave ishin pësuar humbje shumë të rënda, grupi ishte shpërbërë në Qershor 1941. Duke qenë më se i bindur tek koncepti bazë, Stirling mori rrugën dhe arriti të takohet me gjeneralmajorin Neil Ritchie (zv/komandanti i trupave të Afrikës së Veriut & Lindjes së Mesme). Ideja e tij, ishte të ngrinte një grup të ri, nga ajo çfarë kishte mbetur nga trupat komando të "Layforce", duke i organizuar në grupe më të vogla, të cilët do të desantonin nga ajri në afërsi të bazave ajrore të armikut, do të vendosnin eksplozivë më plasje të vonuar dhe pastaj do të ecnin në drejtim të pikave të grumbullimit, nga ku do të merreshin nga grupet e patrullave të distancave të gjata të shkretëtirës (L.R.D.G). Plani dukej i mirë dhe që të dy, Ritchie dhe Komandanti i tij menduan se mund të funksiononte. Në Korrik 1941, Stirling mori lejë të formonte Detashmentin L të Brigadës "jo-ekzistuese" SAS (Special Air Service Brigade), një emër ky që iu vu me qëllim për të çorientuar zbulimin gjerman. Ideja e tij, rezultoi të ishte e vështirë të vihej në praktikë, pa pësuar humbje të mëdha të njerëzve, qofshin këta të vrarë apo të kapur rob. Në një rast katastrofik, vetëm dy veta ia dolën të kthehen sërish në bazë pas operacionit! Duke kujtuar një operacion të suksesshëm në një aeroport, të zhvilluar nga "Layforce", të cilët u mbështetën nga L.R.D.G, me kamionë Chevrolet, në të cilët ishin montuar mitralozë të tipit 303, Stirling mendoi menjëherë për potencialin që paraqisnin Jeep-at, për të transportuar trupat nga penetrimi i tyre në prapavijë të armikut. Mjetet e transportit që ishin në zotërim nga Ushtria Britanike, u morën dhe u përshtatën për përdorim nga SAS-i. Operacioni i parë, i suksesshëm, i tyre erdhi shumë shpejt në 17 Nëntor 1941, kur dy grupe SAS shkatërruan 61 avionë luftarakë në dy aeroporte. Një tjetër operacion, u zhvillua menjëherë pas të parit, dhe këtë herë u shkatërruan 27 avionë luftarakë. Nga

Korriku i 1942 regjimenti do të kishte në posedim 15 Jeep-a të modifikuar për aksione në Afrikën e Veriut. Jeepat ishin "çliruar" nga të gjitha pjesët jo-esenciale, duke përfshirë këtu edhe xhamin e erës, një pjesë e madhe e shufrave të radiatorëve dhe madje në disa raste edhe parakolpin, për të rritur efektivitetin e sasisë së transportit të materialeve nga mjete. Në këtë mënyrë sasia e madhe e karburantit që duhej për të kryer distanca të gjata, mund të merrej me vete duke shmangur vonesat në furnizim. Një pajisje për kondensimin e ujit u montua përpara, në mënyrë që të reduktoheshin humbjet nga radiatorit, i cili në rast të kundërt do të duhej të mbushej nga uji i pijshëm që në fakt ishte i limituar. Xhipat mbanin gjithashtu thasë rëre, radio-pajisje, si dhe një sasi të madhe municioni. Jeep-at ishin të armatosur rëndë, me kombinimin e të dy mitralozave Browning dhe Vickers K. Vickers, një ish-armë e aviacionit, përgjithësisht ishte e montuar me çifte dhe në disa mjete ishin të montuara një total prej 5 mitralozash. Efektiviteti i këtij armatimi, i cili qëllonte një miksim fishekësh të kalibrave të ndryshëm, mund të gjykohej nga një sulm i kryer në një aerodrom, ku për 5 minuta u shkatërruan 12 avionë luftarakë. Me të gjitha armët të montuara, një Jeep i vetëm i SAS mund të qëllonte deri në 5000 fishekë në minutë! Rezultati i kësaj rrjete të shtimesh, ishte shkatërrimi i mbi 400 avionëve luftarakë, në Nëntor 1942. Stirling u kap rob në vitin 1943, por u arratis katër herë përpara se të dënohej dhe të dërgohej në Colditz, ku kaloi gjithë pjesën e mbetur të luftës.

Ndërkohë që fronti lëvizte nga Afrika, në Itali, dhe më pas në Europën Veriperëndimore, të njëjtën gjë bënte edhe SAS. Shkalla e çdo operacioni varioje në mënyrë tronditëse. Në një operacion (të koduar Houndsmith), u parashutuan 144 burra me Jeepa dhe me të gjitha furnizimet, në një zonë afër Dijon, Francë. Në një tjetër operacion, katër burra me dy Jeepa vranë dhe plagosën 60 SS gjermanë, duke shkatërruar dy makina të shtabit dhe një kamion në fshatin Les Ormes, Francë. Gjatë fundit të 1944, SAS filluan të operonin në prapavijë të forcave gjermane në Europë. Modifikimet e mëtejshme të Jeep, përfshinë përdorimin e pllakave të blinduara si dhe xhamave të blinduara të pjesës së përparme të tyre, si dhe një tel-prerës të montuar përpara kësaj makine lufte. Efektiviteti i SAS në Europë gjatë Luftës së Dytë Botërore, mund të gjykohej nga fakti që ata regjistruan rreth 7,733 Gjermanë të vrarë, kapën 4,784 robër dhe 700 mjete u shkatërruan ose u kapën, 164 linja hekurudhore u ndërpreën dhe 7 trena u shkatërruan dhe më se 33 të tjerë u nxorën nga shinat. SAS u shpërbë menjëherë në fund të Luftës së Dytë Botërore, por metodat e organizimit dhe operacionet e kryera, vendosën piketat për organizimin dhe operacionet e ardhshme të SAS-it në Falklands dhe në Luftën e Gjirit Persik.





**Ndahet nga jeta në moshën 68-vjeçare, violinisti i famshëm shqiptar Ibrahim Madhi**

# Ibrahim Madhi mbyll koncertalin...

**M**ë 4 shkurt 2014, u nda nga jeta në moshën 68-vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë, një prej instrumentistëve më të mirë shqiptarë, violinisti Ibrahim Madhi. Ai ka një karrierë mbi 50-vjeçare mes koncertesh e mësimdhëniesh në Universitetin e Arteve dhe të gjithë jetën e tij ia dedikoi violinës. Profesor Ibrahim Madhi lindi në Tiranë më 25 nëntor të vitit 1945. Pasi mbaroi ciklin e plotë të studimeve në Liceun Artistik "Jordan Misja", Tiranë në 1963, u diplomua në Institutin e Lartë të Arteve në 1968 me rezultate të shkëlqyera. Në vazhdim, (1973) ai i komplotoi studimet e tij violinistike me një specializim pasuniversitar pranë konservatorit "San Pietro a Maiella" në Napoli të Italisë. Gjatë karrierës së tij pedagogjike ai ka përgatitur breza të tërë violinistësh e muzikantësh të spikatur. Ai njihet për aktivitet intensiv koncertal si violinist solist, koncert-maester, ansamblist dhe dirigjent ku me përgjegjësi dhe kualitet të lartë artistik ka interpretuar pothuajse të gjithë repertorin violinistik shqiptar, duke i bërë premierë shumicën prej tyre. Është një ndër figurat më të rëndësishme të muzikës dhe artit të interpretimit shqiptar. I njohur për formimin dhe muzikalitetin e tij madhështor, muzikanti i shquar ka dhënë një kontribut të çmuar në formatimin e shkollës kombëtare të interpretimit muzikor. Për meritat dhe kontributin e tij të veçantë, ai gëzoi titullin më të lartë të artit në Shqipëri: "Artist i Popullit". Emri i tij lidhet jo vetëm me të qënurit një solist brilant, por në të njëjtën kohë edhe një drejtues i përkryer i grupeve të muzikës së dhomës dhe orkestrës së harqeve. Brohoritja për shkollën shqiptare të interpretimit violinistik, nuk mund të kuptohet pa emrin e Ibrahim Madhit si një ndër figurat qendrore të kësaj shkolle. Shumë vepra të tjera kapitale të repertorit violinistik morën jetë nga talenti i




mjeshtrit Madhi, në bashkëpunimet e tij me të gjitha orkestrat kryesore shqiptare (Orkestra Simfonike e RTV Shqiptar, Orkestra Simfonike e Teatrit të Operas e Baletit, Orkestra Simfonike e Institutit të Lartë të Arteve, Ansambli i Shtetit, Orkestra e Harqeve të Institutit të Lartë të Arteve, etj.) si dhe me pianistët e shquar, M. Kristidhi, A. Tartari, etj. Që në moshë të re u dallua për prirje të veçanta solistike, por kur në vitin 1962 violinisti 16-vjeçar interpretoi plot siguri e autoritet koncertin e

Mendelssohn-it, i shoqëruar nga Orkestra Simfonike e RTV Shqiptar nën drejtimin e dirigjentit Mustafa Krantja, skena do të ishte sfida e tij më e madhe. Profesor Madhi ka drejtuar dhe katedrën e interpretimit muzikor në Akademinë e Arteve. Ka qenë për vite pedagog, drejtor i Akademisë së Arteve dhe dekan i Fakultetit të Muzikës pranë Akademisë. Në repertorin e tij përfshihen vepra kompozitorësh shqiptarë e të huaj, vepra të luajtura nga Profesor Madhi, ku ai tregoi individualitetin



e tij të spikatur artistik në skenat e Shqipërisë, Kosovës, Turqisë, Rumanisë, Kinës, Greqisë, Italisë, Austrisë, Francës, Gjermanisë, Zvicrës, etj, ku mori vlerësime e duartrokitje të gjata. Ai ishte dhe themelues i Trios Instrumentale të Akademisë së Arteve (1974) si dhe Orkestrës së Harqeve (1977). Ai është themelues dhe anëtar i Trios së Institutit të Lartë të Arteve si dhe i Orkestrës së mirënjohur të Harqeve të këtij institucioni, duke ndihmuar e dhënë një kontribut direkt në

formimin e traditës së lojës në këto ansamble që u bënë të mirënjohura për publikun. Ai ka orë të tëra incizimesh e regjistrimesh në studio apo direkt nga sallat e koncerteve me Radio Tiranën, Televizionin Shqiptar, Radio Prishtinën, Radion e Pekinit (Kinë), Radion e Gracit (Austri), etj, të cilat vazhdojnë të jenë në transmetim. Në nder të tij u zhvilluan homazhe në Universitetin e Arteve, më 5 shkurt nga ora 12:00-13:00. I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij!





## In memoriam

**NJË YLL MË TEPËR NË QIELL,  
NJË DRITË MË PAK NË TOKË**

**Shuhet e madhja  
Vaçe Zela**

*Dikur një prej udhëheqësve të lëkurëkuqve të Amerikës, do jepte këtë këshillë për më të rinjtë, për jetën e për vdekjen: “Kur koha jote të vijë, kur vdekja të trokasë, mos u bë si ata që e kanë zemrën të mbushur me frikën e vdekjes e që kërkojnë mundësi të dyta, apo edhe pak kohë më shumë për të qëndruar në këtë jetë. Jo! Mos kërko më shumë që të jetosh ndryshe apo të bësh atë që pate mundësi ta bëje e që nuk e bëre. Këndo këngën tënde, këngën e fundit, këngën e vdekjes dhe melodia fisnike e zërit tënd, do të jetë si përplasja e flatrave të një shpendi, i cili të ngre ty peshë drejt qiellit, drejt banesës tënde të përjetshme.” Ai i këshillonte të linin gjurmën e tyre dhe të kuptonin natyrën e përkohshme të jetës. Ajo që la Vaçe Zela, është jo vetëm një gjurmë e dallueshme dhe e pashlyeshme në zemrën e Kombit, por është një boshllëk i cili nuk do të mbushet asnjëherë, nga askush, pasi Vaçet lindi vetëm një herë në histori. I përjetshëm qoftë kujtimi i saj, pasi zëri ishte qysh në të gjallë i tillë!*

*A.Hitoaliaj*

